



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 4 regjistër (JR)
Datë 28.01.2019

Nr. 31 i vendimit
Datë 20.11.2019

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga:

Sokol Çomo	Kryesues
Luan Daci	Relator
Albana Shtylla	Gjyqtare
Ardian Hajdari	Gjyqtar
Rezarta Schuetz	Gjyqtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 20.11.2019, ditën e mërkurë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Artor Ylli, me detyrë ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 73, datë 02.11.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Artor Ylli.

BAZA LIGJORE: Nenet 62, 63, 64, 65, 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni F i Aneksit të Kushtetutës, neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Luan Daci, shqyrtoi kërkesat për marrje provash të reja dhe shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Z. Artor Ylli, subjekt rivlerësimi, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit në bazë të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, e cila parashikon se të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*.
 - 1.1. Çështja që i përket juridiksionit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Artor Ylli, me funksion ndihmës ligjor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë (në vijim “GjAShP”) Tiranë, është shortuar në datën 15.05.2018 në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe është shqyrtuar nga trupi gjykues i Komisionit.
2. Në vijim të dorëzimit të deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit – *vetting*, nga subjekti i rivlerësimit në datën 29.01.2017, nga shkresa nr. {***} prot., datë 05.02.2018, e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKP”), rezulton se ky i fundit, pasi ka përgatitur raportin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ka arritur në përfundimet se:
 - a) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;
 - b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - ç) nuk ka kryer deklarim të rremë; dhe
 - d) nuk gjendet në situatë konflikti interesi.
3. Në vijim të dorëzimit të deklaratës për kontrollin e figurës nga subjekti i rivlerësimit në datën 27.01.2017, nga shkresa¹ nr. {***} prot., datë 02.11.2017, e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), rezulton se kjo e fundit pasi ka përgatitur raportin mbi kontrollin e figurës, ka arritur në përfundimet se:
 - a) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 84/2016;
 - b) subjekti i rivlerësimit ka pasur të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës;
 - c) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar; dhe
 - ç) konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.
4. Në vijim të dorëzimit të formularit të vetëvlerësimit profesional nga subjekti i rivlerësimit në datën 27.01.2017 pranë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”), nga shkresa nr. {***} prot., datë 04.10.2018, rezulton se kjo e fundit ka përgatitur raportin për analizimin e *aftësive profesionale, aftësive organizative, etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale*, si dhe të *aftësive personale dhe angazhimit profesional*, bazuar në tri dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës së rivlerësimit, në të dhënat e dokumenteve të tjera bashkëlidhur formularit të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, në pesë dokumente

¹ Deklasifikuar ne vendim të KDZh-së nr. {***}, datë 30.10.2018.

ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe në të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 73, datë 02.11.2018, bazuar në nenet 179/b, D, Dh, E, Ç të Aneksit të Kushtetutës, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, referuar nenit 58, bazuar në pikat 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artor Ylli, me funksion ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

III. Shkaqet e ankimit

6. Kundër vendimit nr. 73, datë 02.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), në të cilin kërkon ndryshimin e vendimit nr. 73, datë 02.11.2018, të trupit gjykues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas nenit 66, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, ose prishjen e vendimit nr. 73, datë 02.11.2018, i korrigjuar, i trupit gjykues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe, në bazë të nenit 58, shkronja “a” dhe nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, konfirmimin në detyrë të tij.
7. Njëpërmjet ankimit² të paraqitur në Komision, datë 04.01.2019, të plotësuar në datën 25.01.2019, dhe njëpërmjet parashtrimeve të paraqitura në Kolegj me shkresat nr. {***} prot., datë 21.10.2019³, nr.

² Së bashku me ankimin, rezulton të jenë paraqitur edhe aktet në vijim: “urdhura pagese TVSH; urdhër pagese tatimi i thjeshtuar mbi fitimin; urdhër pagese kontributet e s/shoqërore dhe shëndetësore; urdhër pagese tatimi mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël; urdhër pagese kontribute shoqërore; kartë av. N.M., lic. nr. {***}, lëshuar nga DhKASH; vërtetim nr. {***} prot., datë 26.09.2008, lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë; kthim përgjigjeje nr. {***} prot., datë 27.12.2018, lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë; vërtetim nr. {***} prot., datë 27.11.2018, lëshuar nga DOT Bashkia Tiranë”.

³ Së bashku me parashtrimet e paraqitura në Kolegj në datën 21.10.2019, rezulton të jenë paraqitur edhe aktet në vijim: “veprim arke, datë 07.07.2006, {***}, udhëzime operative M.M., {***} M.M. p.f., derdhje cash 31.000 USD; veprim arke, datë 28.12.2006, {***}, udhëzime operative M.M., {***} M.M. p.f., derdhje cash 7.000.000 Lekë; mandatarkëtim i datës 08.04.2009, {***} ({***}), s’ka urdhërues, përfitues llog. për tt USD nr. {***}, shuma 9.741,25 USD; formular aplikimi për transfertë, datë 08.04.2009, {***} ({***}), dërguese M.H.M., nr. identifikimi {***}, profesioni “biznes”, burim fondesh “puna”, qëllimi i transfertës “kthim borxhi”, shuma 9.700 USD, përfitues “{***}”, {***}, {***}, {***}, {***}; formular aplikimi për transfertë, datë 06.01.2010, {***} ({***}), dërguese M.H.M., nr. identifikimi {***}, profesioni “biznes”, debitim i llogarisë nr. {***}, burimi i fondeve “puna”, qëllimi i transfertës “shlyerje detyrimi”, përfitues “{***}, {***}, nr. i llogarisë {***}, swift {***}, shuma 12.000 USD; formular aplikimi për transfertë me jashtë, datë 25.03.2009, {***} ({***}), dërguese “M.H.M., tregti”, përfitues {***}, {***}, llogari nr. {***}, {***}, swift {***}, qëllimi i transfertës “shlyerje detyrimi”, shuma 10.000 USD; formular aplikimi për transfertë me jashtë, datë 03.03.2008, {***} ({***}), dërguese M.M., biznes, përfitues “{***}”, {***}, nr. llogarie {***}, {***}, China, swift {***}, qëllimi i transfertës “personale”, shuma 40.000 USD; formular aplikimi për transfertë, datë 12.01.2010, {***} ({***}), dërguese M.H.M., nr. identifikimi {***}, profesioni “biznes”, burimi i fondeve “puna”, pagesë cash nga llogaria nr. {***}, me burim fondesh nga puna, biznes me përfitues: {***}, {***}, llogari nr. {***}, {***}, swift {***}, qëllimi i transfertës “shlyerje borxhi”, shuma 7.000 USD; mandatarkëtimi i datës 12.04.2011, {***} ({***}), N.M., llogaria nr. {***}, shuma 35.100 USD; formular aplikimi për transfertë me jashtë, datë 16.09.2009, {***} ({***}), dërgues “N.M., tregti”, përfitues “{***}”, {***}, nr. llogarie {***}, {***}, China, puna, swift {***}, qëllimi i transfertës “kthim borxhi”, shuma 20.000 USD; formular aplikimi për transfertë me jashtë, datë 25.06.2008, {***} ({***}), dërgues N.M., mënyra e pagesës, nr. llogarie {***}, përfitues “{***}”, {***}, {***}, nr. llogarie {***}, no. {***}, swift {***}, qëllimi i transfertës “kthim borxhi”, shuma 3.000 USD; pasaporta e z. N.M. (hyrje-dalje Kinë), nr. {***}, datë lëshimi 08.11.2003, gjithsej 14;

{***} prot., datë 28.10.2019⁴ dhe nr. {***} prot., datë 30.10.2019⁵, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe akte shkresore, me të cilat ka synuar të provojë pretendimet e ngritura sipas shkaqeve të ankimit që do të renditen më poshtë.

8. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin e ngritur vendimit nr. 73, datë 02.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pretendon se vendimi nuk është i drejtë dhe se përfundimet e Komisionit nuk janë në pajtueshmëri me aktet dhe provat e administruara.

8.1. Vendimi, sipas subjektit të rivlerësimit, ka çuar në etiketim të papërshtatshëm dhe stigmatizim të subjektit të rivlerësimit, duke i konsideruar veprimet e kryera nga subjekti si nga mënyra, edhe nga shkaku, si cilësi të karakterit të subjektit, dhe ka cenuar, sipas subjektit, respektimin e të drejtave dhe lirive të njohura nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNJ”).

8.2. Komisioni, pretendon subjekti i rivlerësimit, ka spekuluar me vlerësimin e sjelljes dhe integritetit të subjektit si asistent avokat dhe më pas si avokat. Ky spekulim, pretendon subjekti, është në kundërshtim me aktet në dosje, si për etikën dhe aspektin e integritetit moral, është paragjykes dhe në të njëjtën kohë fyes, sipas tij.

*pasaporta e z. N.M. (Kinë viti 1998), nr. {***}, datë lëshimi 17.01.1998; pasaporta e znj. M.M. (hyrje, Kinë), nr. {***}, datë lëshimi 17.06.2003; pasaporta e znj. M.M. (Kinë), nr. {***}, datë lëshimi 27.05.1997; mandatarkëtimi i datës 16.04.2008, {***} ({***}), përfitues N.M., nr. llogarie {***}, ({***} USD), N.M., cash, shuma 6.025 USD; mandatarkëtimi i datës 16.04.2008, {***} ({***}), përfitues N.M., nr. llogarie {***}, {***} USD), N.M., cash, shuma 6.025 USD; mandatarkëtimi i datës 31.03.2008, {***} ({***}), N.M., nr. llogarie {***}, {***} USD), cash, shuma 40.102 USD; mandatpagesë e datës 01.04.2008, {***} ({***}), N.M., nr. llogarie {***}, pagesë në cash, shuma 40.092 USD; urdhër debitimi - kreditimi, datë 01.04.2008, {***} ({***}), debito llog. nr. {***}, USD 40.092,00, N.M., shuma dhe kom. TT 357, përshkrimi shuma dhe komisione për TT 357 N.M., kredito “llogari marrëdhënie e T.”, nr. {***}, 40.000 USD, komisione për transfertën USD, “{***}”, 92,00 USD; mandatarkëtimi i datës 18.03.2010, {***} ({***}), urdhërues M.M., përfitues N.M., nr. llogarie {***}, {***} USD), shuma 12.036 USD, komente “dep. në llog. për TT”; mandatarkëtimi i datës 11.01.2010, {***}, M.M., urdhërues, “M.M., përfitues “M.M.”, nr. llogarie {***}, cash, shuma 21.066 USD, komente “depozitë”; shkresa detyrime në kohë reale, {***}, rezulton totali i detyrimeve “0”; printime nga adresat online www.{***}.com dhe www.{***}.com, me verifikimin për kodin e SWIFT {***}, për transfertat e sjella më lart dhe transfertat e kryera nga subjekti rivlerësimit me swift {***}, rezulton se synohet të provojë që 3 transfertat e kryera nga subjekti për llogari të N.M., sipas aktit bashkëlidhur parashtrimeve, ishin me përfitues {***}- {***} (dega {***}), që përkohë me vendin ku ai vetë ka bërë transfertat në {***} (në degën tjetër {***}).*

⁴ Së bashku me parashtrimet e paraqitura në Kolegj në datën 28.10.2019, rezulton të jenë paraqitur edhe aktet në vijim: “shkresa nr. {***} prot., datë 27.12.2018, e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, me lëndë kthim përgjigjeje, dhe nga ku rezulton se z. Artor Ylli ka fituar titullin avokat më 05.12.2009, pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë, mbajtës i licencës nr. {***}, dhe se ka ushtruar profesionin prej vitit 2010 deri në vitin 2014, se prej vitit 2015 e në vazhdim ka kaluar në statusin e avokatit pasiv, se ka kryer stazhin njëvjeçar të asistent avokatit pranë avokat N.M., se nuk ka detyrime financiare dhe se në ngarkim të tij nuk figurojnë masa apo procedime disiplinore në proces; shkresa e datës 11.03.2009 e avokatit N.M. e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, me lëndë kthim përgjigjeje, dhe nga ku rezulton se avokati N.M., me nr. licence {***}, vërteton se z. Artor Ylli është asistent i regjistruar në Dhomën e Avokatëve Tiranë në vitin 2005, se gjatë kësaj periudhe kohore ka shfaqur nivel të lartë profesional dhe kulturor, korrekt dhe i përkushtuar, ka marrë pjesë në përgatitjen e kërkesëpadive të ndryshme dhe në disa seanca gjyqësore, dhe se ka bindjen se është i aftë për të mbrojtur çështje civile dhe penale dhe të marrë licencën e avokatit pasi t'i nënshtrohet provimit përkatës; formular aplikimi për transfertë me jashtë, datë 12.04.2011, {***} ({***}), dërgues “N.M.”, profesioni “jurist”, burimi puna dhe biznesi, qëllimi “shlyerje borxhi”, përfitues “Zh.”, {***}, nr. llogarie {***}, {***}, nr. llogarie {***}, shuma 35.000 USD.

⁵ Së bashku me parashtrimet e datës 30.10.2019, rezulton të jetë paraqitur edhe akti: “Nxjerrje llogarie - Statement i shtetasit N.M. i datës 29.10.2019, të {***} (e cila, pas miratimit të Bankës së Shqipërisë dhe pas përfundimit të procedurave pranë QKB-së, {***} Bank është bërë pjesë përbërëse e {***} Bank), nga ku rezulton transfertat e bërë nga z. N.M. më datë 12.04.2011, në favor të përfituesit “Zh.”, në vlerën 35.000 USD, që përkon me formularin e aplikimit për transfertë, të paraqitur me shkresën nr. {***} prot., datë 28.10.2019.

8.3. Nuk janë marrë në konsideratë, pretendon subjekti i rivlerësimit, çmimi dhe vlerësimi i dokumenteve konfirmuese nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë së Shqipërisë (në vijim “DhKASH”) dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, për efekt të vlerësimit të etikës e integritetit të subjektit.

8.4. Përfundimet e arritura nga vendimi i Komisionit, sipas subjektit të rivlerësimit, në lidhje me veprimet e subjektit për transfertat bankare në mënyrë të përsëritur, të pajustificuara me burime të ligjshme, nuk vlejnë për rastin e tij, pasi:

- a) subjekti nuk është magjistrat sipas ligjit nr. 96/2016, dhe referenca ligjore të ky ligj, nenet 3 dhe 4, është e gabuar, pasi nuk gëzon statusin e magjistratit dhe nuk mund të jetë ky ligj i aplikueshëm për vlerësimin e etikës dhe integritetit të subjektit;
- b) në kohën e kryerjes së transaksioneve nuk ka qenë gjyqtar, por dhe si asistent avokat nuk ka asnjë rregull që ndalon veprimet e tij;
- c) diskriminimi nëpërmjet vendimit ndaj tij, duket tek arsyetimi i Komisionit se shkeljet etike të subjektit nuk ka shkollë që t’i korrigjojë.

8.5. Subjekti i rivlerësimit, pretendon se shumata e transferuara nga Shqipëria në Kinë nga subjekti nuk kalojnë limitet e normave të parashikuara në bankë.

8.6. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, ka ndryshuar edhe deklaratimet e tij gjatë komunikimeve elektronike, për të cilat pretendon se nuk është deklarim i tij, por është pjesë e komunikimit të Komisionit me dëshmitarin, z. N.M., madje dhe këtij të fundit, vijon subjekti i rivlerësimit, i kanë ndryshuar deklaratimet.

8.7. Vendimi i Komisionit, sipas subjektit të rivlerësimit, ka shkelur të drejtat e subjektit të garantuara në nenin 179/b të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNj-së, veprimin e të gjithë institucioneve sipas të drejtës në fuqi.

8.8. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, ka zgjeruar rastin e shkarkimit nga detyra edhe me “vlerësimin tërësor të procedurave” apo “cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë”, që janë nocione të papërkufizuara dhe të panjohura për legjislacionin shqiptar.

8.9. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, ka bërë trajtim të pabarabartë të subjektit në këtë proces, dhe procesi i rivlerësimit ndaj tij është bërë si avokat dhe jo si ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative, çka bie ndesh me nenet 18 dhe 179/b të Kushtetutës. Sipas nenit 18 të Kushtetutës, të gjithë duhet të jenë të barabartë përpara ligjit, dhe ky është diskriminim ligjor, pasi ligji i njej individit të drejtën për të ushtruar lirisht profesionin e avokatit.

8.10. Vendimi, sipas subjektit të rivlerësimit, cenon parimin e sigurisë juridike sepse teksti i tij është i paqartë, konfuz dhe në raste të caktuara, edhe kontradiktor. Vendimi, vijon subjekti i rivlerësimit, ka krijuar situatë paqartësie, pasi i është referuar ligjit nr. 96/2016, për statusin e magjistratit, i cili është një ligj me natyrë të përgjithshme për detyrimet e magjistratëve, ndërkohë që ai nuk është gjyqtar dhe nuk ka statusin e magjistratit. Rregullat e posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit, janë parashikuar në ligjin nr. 84/2016, sikurse dhe procedurat dhe standardet e rivlerësimit nga institucionet e rivlerësimit.

8.11. Parimi i shtetit të së drejtës, sipas subjektit të rivlerësimit, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, dhe ai ka respektuar Kodin Etik të Avokatit.

8.12. Sipas subjektit të rivlerësimit, konkluzionet e nxjerra nga Komisioni në vendim, lidhur me transfertat bankare, bien ndesh me njëra-tjetrën, dhe kanë tendencë të rëndojnë pozitën e subjektit.

8.13. Në lidhje me mospërputhjen për deklaratimet e subjektit dhe z. N.M., duke e lidhur këtë moment si një faktor që ka ndikuar në dhënien e vendimit, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk është bërë e mundur marrja e dokumentit, i cili do të vërtetonte marrëdhënien midis subjektit dhe z. N.M. Kjo, sipas tij, është një rrethanë njohjeje midis subjektit dhe z. N.M. Subjekti e lidh cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe cenimin e standardit të arsyesimit të vendimit, me mosadministrimin e dy akteve nga Komisioni, që lidhen me vërtetimin e punësimit.

8.14. Vendimi i Komisionit, sipas subjektit të rivlerësimit, duhet të jetë i tillë në arsyetim që t'u tregojë palëve se ata janë dëgjuar, dhe ky vendim i arsyetuar u jep palëve të drejtën për t'u ankuar kundër vendimit, dhe kjo çon në shqyrtimin publik të administrimit të drejtësisë, pra, sipas tij, vendimet gjyqësore duhet të merren në pajtim me ligjin, me baza të arsyeshme si në nivelin procedural, ashtu dhe në atë material. Këto dokumente paraqesin të dhëna të nevojshme për të bërë një vlerësim të plotë dhe të gjithanshëm të komponentëve të rivlerësimit, duke investiguar të gjitha rrethanat dhe çdo të dhënë të nevojshme për hetimin e çështjes, me qëllim arritjen e një konkluzioni të bazuar në prova, të mbledhura në përputhje me ligjin. Hetimi nga Komisioni duhet të ishte i plotë, dhe këto momente që lidhen me rivlerësimin duhet të sqarohen plotësisht për sa trajtohet në shkresat përkatëse.

8.15. Komisioni, pretendon subjekti i rivlerësimit, ka dështuar në detyrën e tij, në vendimmarrjen objekt ankimi, për të lidhur në mënyrë të mjaftueshme rregullat e zbatueshme me faktet e rastit, sikurse kërkohet për një vendim të arsyetuar sipas së drejtës për një gjykim të drejtë. Drejtësia procedurale, sipas subjektit të rivlerësimit, kërkon që pretendimeve esenciale që palët ngrenë në proces, t'u përgjigjet në mënyrën e duhur gjykata, në pajtueshmëri me kërkesat e së drejtës për gjykim të drejtë.

8.16. Lidhur me transfertat bankare të kryera nga subjekti pranë {***} (në vijim “{***}”), subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzionet nuk janë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, dhe se Komisioni nuk ka vërtetuar nëse shumat e këtyre transfertave kanë të bëjnë me të ardhura që i takojnë subjektit ose me lidhjet bilaterale në favor të të tretëve. Komisioni, sipas tij, nuk ka provuar se me kryerjen e këtyre transfertave, subjekti ka kryer veprime të kundërligjshme. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka deklaruar të ardhura që lidhen me këto transferta dhe, si të tilla, nuk ka detyrim për të justifikuar burimin e ligjshëm të këtyre, dhe se këto transferta janë kryer në një kohë kur ankuesi nuk ka qenë subjekt rivlerësimi dhe nuk ka pasur asnjë funksion shtetëror.

8.17. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk ka provuar se ai ndodhet në kushtet e pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Në kohën që ai ka kryer këto transferta nuk ka qenë subjekt deklarues, ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së lëvizjen e llogarisë të tij në {***}, ku pasqyrohen dhe këto transferta, dhe nuk ka pasuri të deklaruara dhe as pasuri të fshehura të gjetura nga Komisioni.

8.18. Veprimet e tij, vijon subjekti i rivlerësimit, nuk kanë qenë përcaktuese në mundësinë e kryerjes së evazionit fiskal nga tatimpaguesja M.M., si person fizik.

8.19. Subjekti i rivlerësimit pretendon se argumentet e pjesës arsyesuese të vendimit, lidhur me detyrimet tatimore dhe taksat e papaguara, nuk janë të bazuara dhe të lidhura logjikisht.

8.20. Subjekti i rivlerësimit thekson se nuk mund t'i bëhet rivlerësimi si kandidat për magjistrat, dhe se ai nuk ka pasur apo nuk ka procedim disiplinor as si avokat, as si ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative, rrethana këto që nuk janë mbajtur pasur parasysh në vendimin e Komisionit ndaj tij.

8.21. Komisioni, sipas tij, ka bërë konstatim të gabuar, pasi ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pasakta, dhe pretendon që veprimet e kryera nga ai nuk tregojnë mungesë të etikës dhe integritetit të tij, pasi nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të ketë kryer veprime të kundërligjshme apo veprime që kanë cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, duke marrë në konsideratë këtu veprime që janë kryer në një kohë kur subjekti nuk ka qenë pjesë e sistemit të drejtësisë (2010-2015). Për këto veprime të tij, shprehet subjekti i rivlerësimit, nuk ndodhet në asnjë nga rastet e parashikuara nga ligji nr. 84/2016, neni 61 për shkarkimin nga detyra.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

9. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, për sa i përket juridiksionit të Kolegjit, ky i fundit ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet e subjekteve të rivlerësimit kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e tyre, të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

9.1. Gjithashtu, sipas përcaktimeve të nenit 165, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, dispozitat kalimtare, këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, *ndihmësi ligjor* pranë Prokurorisë e Përgjithshme dhe *në gjykatat administrative*, si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”⁶.

9.2. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artor Ylli, me detyrë ndihmës ligjor pranë GjASHP Tiranë, ajo bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet e subjekteve të rivlerësimit ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

10. Për sa i përket legjitimitetit të ankuesit, subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* sipas parashikimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.
11. Lidhur me kërkesën e marrjes së provave të reja me shkresat nr. {***} prot., datë 21.10.2019, nr. {***} prot., datë 28.10.2019, dhe nr. {***} prot., datë 30.10.2019, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se një pjesë e atyre akteve që subjekti kërkon të merren si prova të reja i janë bashkëlidhur ankimit, kurse disa akte të tjera janë paraqitur në Kolegj, pasi ishte depozituar ankimi i subjektit të rivlerësimit.

⁶ Për efektin kohor të kryerjes së veprimeve, legjitimitetin e Komisionit dhe Kolegjit, për investigimin e transfertave të kryera, konsiderohen informacione dhe vlerësime sipas nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 në raport me sjelljen e tij gjatë procesit sipas nenit 43, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me këto prova, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provon se pa fajin e tij, sipas nenit 47⁷ të ligjit nr. 49/2012, nuk ka mundur t'i paraqesë këto prova dhe faktet që ai synon të provojë nëpërmjet tyre në Komision. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ato kanë qenë prova të cilat ka qenë e mundur objektivisht për subjektin e rivlerësimit të paraqiteshin gjatë shqyrtimit në Komision⁸. Për sa u përket provave që janë paraqitur pas depozitimit të ankimit, trupi gjykues i Kolegjit konsideron se një paraqitje e tillë nuk lejohet nga parashikimet e ligjit nr. 49/2012, dhe konkretisht nuk janë respektuar nga subjekti i rivlerësimit kërkesat e nenit 47 dhe nenit 49, pika 2 e këtij ligji dhe, për pasojë, Kolegji vendosi mospranimin e tyre për shqyrtim⁹.

12. Për sa i përket kërkesës për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, duke u nisur edhe nga rrëzimi i kërkesës së parë, por njëkohësisht dhe nga mosverifikimi i ekzistencës së asnjë prej kushteve të parashikuara në nenin 51¹⁰ të ligjit nr. 49/2019, kjo kërkesë duhet të rrëzohet dhe gjykimi i çështjes të vazhdojë në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi¹¹.
13. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit, si shkak procedural ngre pretendimin se legjislatori nuk ka parashikuar që *kandidatët për magistratë* duhet t'i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, sikurse dhe se veprimet e kryera nuk tregojnë mungesë të *etikës* dhe *integritetit* të cilat mund të cenojnë figurën e tij.

13.1. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendon se ligji nr. 96/2016 nuk është i zbatueshëm për çështjet e *etikës* dhe të *integritetit*, duke marrë në konsideratë këtu që rrethanat për të cilat është shkarkuar nga detyra kanë ekzistuar në një kohë që ky i fundit nuk ka qenë pjesë e sistemit të drejtësisë.

14. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se subjekti i rivlerësimit i është nënshtrohet procesit të rivlerësimit për arsye se me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016 ushtronte detyrën e ndihmësit ligjor pranë GjASHP Tiranë.

14.1. Neni 179/b, pika 4 e Kushtetutës përcakton se: “4. Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*. Procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet”. Gjithashtu, me referim të ndërsjellë, neni

⁷ Neni 47 i ligjit nr. 49/2012 përcakton se: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

⁸ Shih f. 2, paragrafi i parafundit i procesverbalit në dhomë këshillimi.

⁹ Shih f. 2, paragrafi i fundit dhe f. 3 paragrafi i parë i procesverbalit në dhomë këshillimi.

¹⁰ Neni 51 i ligjit nr. 49/2012 përcakton se: “1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë. 2. Vendimi i mësipërm, data dhe ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve rregullisht nga sekretaria gjyqësore, të paktën 10 ditë para datës së zhvillimit të seancës gjyqësore”.

¹¹ Shih f. 3, paragrafi i tretë i procesverbalit në dhomë këshillimi.

165, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, që rregullon statusin e gjyqtarëve, përcakton se: “Këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë e Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

15. Nga cilindo këndvështrim apo funksion, ky subjekt rivlerësimi duhet t'i nënshtrohet rivlerësimit, meqenëse rezulton se ka përfituar nga neni 165, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, pasi kjo dispozitë e fundit zbatohet vetëm për subjektet që kanë plotësuar kushtet e pikave 1 dhe 3 të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, domethënë subjekti i rivlerësimit Artor Ylli ka përfituar nga ligji i statusit dhe do të përballlet me kërkesat e tjera të këtij ligji. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit çmon se shkak për të cilin i është nënshtuar procesit të rivlerësimit është ushtrimi i funksionit të *ndihmësit ligjor pranë GjASHP Tiranë*, dhe jo cilësia e kandidatit për magjistrat, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, dhe për këtë arsye trupi gjykues i Kolegjit vlerëson si të pabazuar pretendimin se rivlerësimi i tij është kryer për shkak të së drejtës të fituar si pasojë e nenit 165 të ligjit nr. 96/2016¹², pas rezultateve të testimit në Shkollën e Magjistraturës, sipas nenit 42, pika 2, germa “b” e ligjit nr. 84/2016¹³, përkatësisht:
- për të ndjekur programin teorik të Shkollës së Magjistraturës për një vit;
 - për të kryer praktikën profesionale për një vit;
 - për të përfituar pagë gjatë periudhës dyvjeçare; dhe
 - për t'u emëruar si magjistrat, në përfundim të trajnimit dyvjeçar, sipas renditjes në bazë të rezultateve të provimit përfundimtar në fund të vitit të parë dhe të vlerësimit etik dhe profesional gjatë praktikës profesionale.

15.1. Nga shkresa nr. {***} prot., datë 27.09.2018, e Shkollës së Magjistraturës, rezultoi se në mbështetje të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, subjekti i rivlerësimit bënte pjesë në subjektet të cilët kishin marrë të paktën 60% të pikëve në testimin e aftësive profesionale dhe se kishte të drejtë të ndiqte programin dyvjeçar të praktikës profesionale në Shkollën e Magjistraturës.

16. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se të drejtat e parashikuara nga neni 165, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, janë të drejta që u lindin, ndër të tjerëve, edhe ndihmësve ligjorë pranë GjASHP-së, të cilët kishin

¹² Neni 165, pikat 4, 5 dhe 6 të ligjit nr. 96/2016, përcaktojnë se: “4. Subjektet e parashikuara në pikat 1 dhe 3, të këtij neni, të cilët kanë arritur të paktën 60 për qind të pikëve të testit të aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës, sipas parashikimeve të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kanë të drejtë: a) të ndjekin programin teorik njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës; b) të caktohen brenda afatit 1-mujor pas përfundimit të programit të trajnimit për një vit për të kryer praktikë profesionale në gjykata ose prokurori të ndryshme, duke zbatuar parashikimet e nenit 33 të këtij ligji, për aq sa gjejnë zbatim; c) të përfitojnë gjatë periudhës dyvjeçare të trajnimit, të parashikuar në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, respektivisht pagë të barabartë me pagën e ndihmësit ligjor, inspektorit ose këshilltarit të gjyqtarit. 5. Ndihmësi ligjor, inspektori dhe këshilltari i gjyqtarit, në kuptim të pikës 4, të këtij neni, marrin pjesë në provimin përfundimtar në përmblyllje të vitit të tyre të parë në Shkollën e Magjistraturës. Ata caktohen për praktikë profesionale dhe vlerësohen gjatë saj, në përputhje me nenin 33 të këtij ligji. 6. Në përfundim të trajnimit dyvjeçar, ndihmësi ligjor, inspektori dhe këshilltari i gjyqtarit, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, renditen sipas rezultateve të provimit përfundimtar në fund të vitit të parë dhe të vlerësimit etik dhe profesional gjatë praktikës profesionale. Ata përfshihen në listën e renditjes dhe emërohen si magjistratë, sipas parashikimeve të këtij ligji, nëse marrin të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme në provimin përfundimtar në fund të vitit të parë, si dhe janë vlerësuar të paktën “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë praktikës profesionale”.

¹³ Neni 42, pika 2, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, përcakton se: “2. Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës”.

arritur të paktën 60% të pikëve të testit të aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës, për t'u emëruar magjistratë, në përfundim të procedurave¹⁴.

Ky subjekt rivlerësimi, nga çdo këndvështrim kronologjik dhe përmbajtësor, duhet t'i nënshtrohet rivlerësimi, pasi ka qenë ndihmës ligjor, ka shprehur interes dhe ka fituar 60% të pikëve në Shkollën e Magjistraturës, për të vazhduar të jetë pjesë e sistemit të drejtësisë. Përjashtimi do të zbatohet vetëm nëse jepte dorëheqjen dhe përballonte pasojat.

17. Ligji nr. 84/2016, me qëllim përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të subjekteve të rivlerësimi, për situata të caktuara ligjore¹⁵, referon në mënyrë të drejtpërdrejtë në dispozitat e ligjit të statusit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

17.1. Për efekt të procedurave të rivlerësimi janë parashikuar me referim dispozita të veçanta të ligjit të statusit. Ndër funksionet e tjera brenda sistemit gjyqësor, edhe për ndihmësit ligjorë, neni 165, pika 1 e ligjit nr. 96/2016 përcakton detyrimin ligjor për t'u rivlerësuar, me qëllim përmbushjen e standardeve të përcaktuara nga ky ligj, të cilat u mundësojnë magjistratëve të ardhshëm qenien pjesë e sistemit të drejtësisë, duke përfaqësuar më të mirën e sistemit, qoftë duke u caktuar nëpunës civilë gjyqësorë në sistemin gjyqësor që i përshtatet më së miri profilit të tyre aktual, për të cilin përmbushin kriteret, qoftë edhe duke ndjekur fushën e karrierës së magjistratit, sipas përcaktimeve të nenit 165, pika 9 e ligjit nr. 96/2016.

17.2. Përmbushja e standardeve të përcaktuara nga ligji nr. 96/2016, mund të jetë objekt i vlerësimit tërësor të procedurave, sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2014, për aq sa përcaktimet e ligjit të statusit nuk bien ndesh me përcaktimet e procedurave të rivlerësimi.

18. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimi që kriteri i kontrollit të pasurisë në rastin e tij i referohet kohës përpara punësimit të tij në GjAShP Tiranë, duke iu referuar jurisprudencës së Kolegjit¹⁶ për kriterin e pasurisë, për nga natyra, rivlerësimi është analizë e së shkuarës së një funksionari publik, duke mbajtur në konsideratë që objekt kontrolli është pasuria dhe për këtë shkak institucionet e rivlerësimi kontrollojnë burimin (në të shkuarën) me të cilin është krijuar kjo pasuri, dhe rivlerësimi (*vetting*) mund të përkufizohet si vlerësim i integritetit për të përcaktuar përshtatshmërinë për funksione publike.
19. Gjithashtu, sipas jurisprudencës së Kolegjit¹⁷, në një interpretim të dispozitave të zbatueshme lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurive, sipas qëllimit të procesit të rivlerësimi kalimtar, të përcaktuar në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës dhe në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues

¹⁴ Neni 165, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016, me titull "Dispozita kalimtare për ndihmësit ligjorë, këshilltarët e gjyqtarëve dhe inspektorët jomagjistratë", përcaktojnë se: "1. Këshilltari i gjyqarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë e Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimi, në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". 2. Subjektet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, në përputhje me parashikimet ligjore, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore, ose si rezultat i procesit të rivlerësimi, në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". 3. Ish-këshilltari i gjyqarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe pranë Gjykatës së Lartë, nëse ka të paktën pesë vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës, duke përfshirë të paktën tre vjet si këshilltar i gjyqarit ose ndihmës ligjor në këto gjykata, mund të kërkojë t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimi, në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

¹⁵ Shih nenet 40, 42, 43, 44, 58, 59 të ligjit nr. 84/2016.

¹⁶ Shih paragrafin 39 të vendimit nr. 19/2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

¹⁷ Shih paragrafin 20.5 të vendimit nr. 6/2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

i Kolegji ka arritur në konkluzionin se nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive, synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit, apo rezultojnë të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj. Konfirmimi i një marrëdhënieje të tillë të magjistratit në raport me ligjin dhe publikun, qoftë në formën e veprimeve të tij në kundërshtim me ligjin, apo edhe në formën e pranimit të veprimeve të personave të lidhur me të, cenon vlerat themelore të tij, si rrjedhojë, edhe besimin që ai duhet të përcjellë te publiku në përmbushjen e misionit/rolit në dhënien e drejtësisë.

20. Kolegji në vendimin nr. 26, datë 21.10.2019, ka arsyetuar se: “Duke vlerësuar në tërësi të tria kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, rezultojnë disa rrethana të cilat të analizuar së bashku e të para në raport me njëra-tjetrën tregojnë për një sjellje e raport të subjektit të rivlerësimit me detyrën, e cila do të ishte e papranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe te roli i subjektit, si një funksionar i denjë i atij sistemi. Në këto rrethana përfshihen si problematika e konstatuar në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë, në lidhje me konstatimet për pasuritë e fshehura të subjektit dhe përdorimit të tyre drejt realizimit të një standardi jetese që nuk përputhet me nivelin e pëlqyeshëm që do i takonte një funksionari publik në sytë e publikut”.¹⁸

21. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procedurës së rivlerësimit në bazë të ligjit nr. 84/2016, për shkak të funksionit që ushtronte si ndihmës ligjor pranë GjAShP Tiranë, ligj i cili ka për synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e sistemit të drejtësisë¹⁹, duke përjashtuar nga sistemi ato subjekte që nuk përmbushin vlerat themelore, dhe që për këtë arsye janë të papërshtatshëm për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë.

21.1. Ligji nr. 96/2016 përcakton *vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes*, të cilat vendosen në themel të *mbrojtjes dhe forcimit* të besimit të publikut, të cilin ka për qëllim të rikthejë procesi i rivlerësimit, sipas përcaktimeve të nenit 179/b të Kushtetutës, të neneve A, B, C, Ç, D, Dh, E, Ë, F dhe G të Aneksit Kushtetues, si dhe të ligjit nr. 84/2016.

21.2. Rrethanat që potencialisht mund të rezultojnë nga vlerësimi i pasurive dhe që vijnë në kundërshtim me *vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes*, të vendosura në themel të *mbrojtjes dhe forcimit* të besimit të publikut, me ligjin nr. 96/2016, mund të përbëjnë shkak për vlerësimin tërësor të procedurave sipas përcaktimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

22. Në përfundim të vlerësimit të transfertave të kryera nëpërmjet {***}-së, Komisioni ka arritur në përfundimet²⁰ se:

a) subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm se shumtat që ai ka transferuar në llogari të z. Zh. në Republikën e Kinës kanë burim tregtinë e mallrave ose që detyrimi dhe borxhi ndaj z.

¹⁸ Shih paragrafin 111 të vendimit nr. 26, datë 21.10.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

¹⁹ Neni 1 i ligjit nr. 84/2016, përcakton se: “Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisht së sistemit të drejtësisë, si dhe **rikthimin e besimit të publikut** tek institucionet e këtij sistemi, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës”.

²⁰ Shih f. 8, paragrafin e fundit, f. 9 dhe f. 10, paragrafin e parë të vendimit nr. 73, datë 02.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

- Zh. në Republikën e Kinës ishte për blerje mallrash, pasi subjekti nuk paraqiti asnjë kontratë apo dokument tjetër që ta vërtetonte këtë, apo edhe shpjegim bindës;
- b) subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e ligjshme nga ai vetë apo nga z. N.M., që janë përdorur për krijimin e shumave të transferuara, si më poshtë:
- i) në datën 14.12.2010, në vlerën 16000 USD, me përfitues z. Zh.;
 - ii) në datën 13.02.2012, në vlerën 30000 USD, me qëllim shlyerje detyrimi; dhe
 - iii) në datën 02.11.2010, transfertë *cash* në vlerën 10000 USD, me përfitues z. Zh., me qëllim shlyerje detyrimi;
- c) subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor provues lidhjen dhe shkakun se përse ai duhet të kryente këtë transfertë në favor të z. N.M. apo biznesit të tij familjar duke provuar se:
- i) ai ka qenë asistent pranë avokatit N.M., më datë 01.09.2008, pranë zyrës së tij avokatore, pasi nuk paraqiti as dokumente që provonin se z. N.M. kishte qenë avokat dhe as vërtetim nga Dhoma e Avokatisë Tiranë se ai ishte i regjistruar në regjistrin e asistentëve avokatë pranë av. N.M., sipas ligjit për avokatinë;
 - ii) ku janë njohur subjekti i rivlerësimit me z. N.M.;
- ç) në lidhje me vendin e njohjes, ka mospërputhje midis deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe deklarimeve të dhëna nga shtetasi N.M., i cili thotë se e ka njohur subjektin e rivlerësimit që në vitet 2008-2009, e ka pasur student të shkolla jopublike “{***}” dhe, më pas, ka qenë asistent avokat pranë zyrës së tij të avokatisë, për efekt të provimit përfundimtar të avokatisë, meqenëse i duhej vërtetim si asistent avokat, ndërsa nga deklarimi në formularin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka mbaruar studimet në Universitetin e {***}, Fakulteti i Drejtësisë”;
- d) deklaratimet e bëra nga z. N.M. nuk u provuan me dokumentacion ligjor provues me qëllim që të mbështesnin deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me shkakun e kryerjes së këtyre transfertave, si dhe mundësitë financiare nga burime të ligjshme të këtyre shumave;
- dh) subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë dokument shoqërues që të vërtetonte burimin e transfertave – për transfertat tregtare me mallra, subjektet e licencuara kërkojnë nga klientët e tyre paraqitjen e këtij dokumentacioni:
- i) kërkesa për kryerjen e veprimit e nënshkruar nga vetë kërkuesi ku pasqyrohet natyra e veprimit dhe qëllimi për të cilin kryhet ky veprim – në këtë kërkesë, subjekti deklaroi se dokumentacioni i paraqitur nuk është përdorur më parë për të justifikuar kryerjen e transfertave të tjera për të njëjtin mall dhe vlerë;
 - ii) fatura pro-forma dhe/ose kontrata ku përcaktohet edhe forma e pagesës;
- e) subjekti i rivlerësimit pranon se ka kryer këto transfertat në vitet 2010-2012 dhe në vite të tjera deri në janar të vitit 2015, ka transferuar jashtë vendit në çdo rast shumë të lejuar prej 3,5 milionë lekësh, duke e ditur që ky ishte një veprim i cili favorizonte biznesin e z. N.M., duke kryer evazion tatimor.
23. Për sa i përket konstatimit të fakteve, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit në datën 14.12.2010, ka kryer transfertën me vlerë 16000 USD, me përfitues z. Zh., me qëllim “borxh i prapambetur”, në datën 13.02.2012, me qëllim “borxh”²¹, përfitues z. Zh. ka kryer transfertën me vlerë 30000 USD, në datën 02.11.2010, ka kryer transfertën *cash* me vlerë 10000 USD, me përfitues z. Zh., me qëllim shlyerje detyrimi, dhe se subjekti i rivlerësimit pranon se ka i kryer këto transfertat në vitet 2010 - 2012, sikurse ka kryer transfertat edhe në vite të tjera deri në janar të vitit 2015.

²¹ Sipas shkresës së {***}-së prot. {***}, datë 03.07.2018.

24. Në lidhje me rrethanat e njohjes me z. N.M., nga materialet e dosjes, vërehet se janë administruar aktet e mëposhtme, nga përmbajtja e të cilave rezulton se:
- a) nga procesverbali për marrjen e deklarimeve të shtetasit N.M., datë 01.10.2018, ora 11:00, i nënshkruar vetëm nga z. N.M., rezulton se në përgjigje të pyetjes së komisionerit Roland Ilia: “Kur jeni njohur ju me z. Ylli?” – ai është përgjigjur: “E njoh që në vitin 2008-2009. E kam pasur student kur kam qenë te shkolla jopublike “{***}” dhe më pas ai ka vazhduar si asistent avokat pranë zyrës së avokatisë që unë kam, për efekt të dhënies së provimit përfundimtar të avokatisë, pasi i duhej një vërtetim si asistent avokat. Ishte një marrëdhënie korrekte, ai shkonte përfaqësonte në gjykata, pra kishte njohje të ligjit dhe ishte djalë me vlerë. Gjatë kësaj kohe kam punuar me të”;
 - b) nga rezultatet e hetimit administrativ, më datë 01.10.2018, rreth orës 11:00, u paraqit në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit shtetasi N.M. Nga ana e Komisionit iu mor deklarim këtij shtetasi, i cili ndër të tjera deklaroi se e ka njohur subjektin e rivlerësimit që në vitet 2008-2009, pasi e ka pasur student te shkolla jopublike “{***}” dhe më pas ai ka qenë asistent avokat pranë zyrës së tij të avokatisë, për efekt të provimit përfundimtar të avokatisë, meqenëse i duhej vërtetim si asistent avokat, ndërsa nga dokumentacioni i administruar në dosje, provohet se subjekti ka mbaruar studimet dhe është diplomuar me titullin “jurist” në Universitetin e {***}, Fakulteti i Drejtësisë.
25. Sipas mendimit të pakicës në Komision në lidhje me rrethanat e njohjes me z. N.M., rezulton se pakica shpjegon se *lidhur me faktin e mospasqyrimin saktë të dëshmisë së dhënë nga z. N.M., konstaton se në procesverbalin mbi marrjen e deklarimeve të zbardhura në datën 01.10.2018 nuk është pasqyruar saktë dëshmia e dhënë nga z. N.M., lidhur me rrethanat e njohjes së tij me subjektin e rivlerësimit, dhe nga deklaratat e marra nga z. N.M. në prezencën time, në cilësinë e relatorit të çështjes, dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, nga dëshmitari u evidentua fakti se e ka njohur subjektin e rivlerësimit pasi vëllain e tij e ka pasur student te shkolla jopublike “{***}” dhe se më pas ka qenë asistent pranë zyrës së tij të avokatisë, ndërsa nga dokumentacioni i administruar në dosje, provohet se subjekti ka mbaruar studimet dhe është diplomuar jurist në Universitetin e {***}, Fakulteti i Drejtësisë.²²*
26. Nisur nga rrethanat e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit, sipas përcaktimit të nenit 49, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, konstaton se është fakt i njohur për Komisionin se z. N.M. e ka njohur subjektin e rivlerësimit nëpërmjet vëllait të këtij të fundit, pasi vëllanë e tij subjekti i rivlerësimit e ka pasur student te shkolla jopublike “{***}”, se më pas ka qenë asistent pranë zyrës së tij të avokatisë, dhe se subjekti i rivlerësimit ka mbaruar studimet dhe është diplomuar jurist në Universitetin e {***}, Fakulteti i Drejtësisë.
- 26.1. Për efekt të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ka rëndësi nëse janë konstatuar shkelje ligjore në lidhje me transaksionet e kryera, të tilla që sjellin pasoja për subjektet e rivlerësimit.
- 26.2. Fakti i qenies asistent pranë avokatit dhe vazhdimi i miqësisë me këtë të fundit, janë çështje motivimi dhe jo çështje që lidhen me shkelje ligjore gjatë transaksioneve bankare.

²² Shih f. 21, paragrafin e dytë, mendimi i pakicës, të vendimit nr. 73, datë 02.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

27. Në komentarin e Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore është trajtuar gjerësisht sjellja e gjyqtarëve në veprimtarinë jashtëgjyqësore, duke e lidhur me elemente të dinjitetit, integritetit, paanësisë dhe reputacionit, ndër të tjera²³.

27.1. Për sa i përket sjelljes së gjyqtarëve në komentar shtjellohet, ndër të tjera:

- a) Paragrafi 108 - Kërkohej respektimi i rreptë i ligjit – “Shkelja e ligjit nga një gjyqtar mund të dëmtojë reputacionin e funksionit si gjyqtar, të inkurajojë mosrespektimin e ligjit dhe të cenojë besimin e publikut në integritetin e vetë gjyqësorit. [...] Një gjyqtar është i detyruar të mbështesë ligjin. Ai ose ajo nuk duhet të vendoset në një pozicion konflikti në zbatim të ligjit. Çfarë të tjerët mund të shihet si një shkelje relativisht e vogël, te gjyqtari mund të tërheqë publicitetin dhe të dëmtojë imazhin e gjyqtarit dhe të shtrojë pikëpyetje në lidhje me integritetin e tij/saj dhe integritetin e gjyqësorit”.
- b) Paragrafi 109 - Sjellja personale e një gjykatësi ndikon në të gjithë sistemin gjyqësor – “Besimi në gjyqësor bazohet jo vetëm në kompetencën dhe zellin e anëtarëve të tij, por edhe mbi integritetin dhe drejtësinë e tyre morale. Gjykatësi jo vetëm që duhet të jetë një “gjyqtar i mirë”, por edhe një “person i mirë”, edhe nëse pikëpamjet për çfarë nënkupton ky koncept mund të ndryshojnë në qarqe të ndryshme të shoqërisë. Nga këndvështrimi i publikut, një gjykatës jo vetëm që është zotuar t’u shërbejë idealeve të drejtësisë dhe të së vërtetës, mbi të cilat është ndërtuar shteti ligjor dhe themelet e demokracisë, por edhe t’i mishërojë ato. Në përputhje me rrethanat, cilësitë personale, sjellja dhe imazhi që projekton gjyqtari ndikojnë në sistemin gjyqësor në tërësi dhe, rrjedhimisht, edhe në vetë besimin që publiku vendos në të. Kërkesat e publikut ndaj gjyqtarëve janë shumë më të larta sesa kërkohej nga bashkëqytetarët, standarde të sjelljes që janë shumë më të larta se ato të kërkuara të shoqërisë në tërësi. Në fakt, publiku pret një sjellje pothuajse të paqortueshme nga një gjykatës. Është sikur funksioni gjyqësor, që është gjykimi i të tjerëve, ka imponuar një kërkesë që gjyqtari të mbetet përtej gjykimit të arsyeshëm të të tjerëve në çështje që mund të cenojnë në çfarëdo mënyre rolin gjyqësor dhe gjykatën”.
- c) Paragrafi 111 - Si mund të duket kjo në sytë e publikut – “[...] Ajo që ka më shumë rëndësi nuk është çfarë bën apo nuk bën një gjyqtar, por ajo që të tjerët mendojnë se ka bërë gjyqtari ose mund të bëjë [...]”.

28. Pavarësisht se para Komisionit nuk është paraqitur vërtetim nga DhKASH, se z. N.M. ishte avokati pranë të cilit subjekti i rivlerësimit ka kryer praktikën si asistent avokat, nga vërtetimi i datës 01.09.2008, i lëshuar nga av. N.M., nga pohimet e subjektit të rivlerësimit nëpërmjet shkresës *kthim përgjigjeje* të datës 13.08.2018 dhe nga deklarimi²⁴ para Komisionit, datë 01.10.2008, të z. N.M., rezultojnë rrethanat e njohjes në drejtim të motivimit për kryerjen e transaksioneve për shkak të praktikës si asistent avokat, që më pas kanë evoluar në marrëdhënie shoqërore.

29. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se deklaratimet e dhëna nga z. N.M. bien ndesh me rregullat e zbatueshme në kohën e kryerjes së transaksioneve bankare, sikurse vëren se ka edhe kundërthënie ndërmjet vetë fakteve të deklaruara nga z. N.M.

²³https://www.unodc.org/res/ji/import/international_standards/commentary_on_the_bangalore_principles_of_judicial_conduct/bangalore_principles_english.pdf

²⁴ Në lidhje me aspektet formale të shkresës dhe deklaratimit para Komisionit, neni 61 i K.Pr.Administrative përcakton se: “Rregullat e përcaktuara në këtë Kod për paraqitjen e kërkesës zbatohen edhe për paraqitjen e mendimeve, shpjegimeve, komenteve, deklaratave, si dhe dokumenteve të tjera, në kuadër të procedurës administrative”.

29.1. Deklarimi i z. N.M. se “ka transferuar pothuajse në çdo rast shumë të lejuar si shtetas shqiptar prej 3,5 milionë lekësh”, bie ndesh me rregulloren në fuqi të Bankës së Shqipërisë. Rregullorja e Bankës së Shqipërisë nr. 64, datë 30.07.2003²⁵, është shfuqizuar me rregulloren e Bankës së Shqipërisë nr. 70, datë 30.09.2009. Në kohën e kryerjes së transaksioneve, në fuqi ishte rregullorja e Bankës së Shqipërisë nr. 70, datë 30.09.2009, e cila nuk përcaktonte kufizime në vlerat e transfertave²⁶, dhe jo rregullorja nr. 64, datë 30.07.2003, e Bankës së Shqipërisë, sikurse gabimisht i është referuar asaj z. N.M.

29.2. Rregullorja e Bankës së Shqipërisë nr. 70, datë 30.09.2009, “Për veprimtarinë valutore”, ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 158, datë 22.11.2009, ndërkohë që transaksionet bankare të konstatuara nga Komisioni datojnë respektivisht në datat 14.12.2010, 13.02.2012 dhe 02.11.2010.

29.3. Z. N.M., në shkresën kthim përgjigjeje, deklaroi se: “[...] duke pasur marrëdhënie të mira shoqërore me Artor Yllin, sasinë e USD në një rast 16050 dhe në një tjetër 30080 USD janë kryer për llogarinë, por nga/dhe në emër të Artor Yllit”, ndërkohë që në paragrafin më poshtë z. N.M. deklaroi se: “[...] jo vetëm në vitin 2010 dhe 2012, por edhe në vite të tjera deri në janar 2015, kam transferuar pothuajse në çdo rast shumë të lejuar si shtetas shqiptar, prej 3,5 milionë lekësh. Por detyrimet që kisha në Kinë nga blerja e mallrave ishin më të mëdha se 3,5 milionë lekë, prandaj këto diferenca të shumave janë kryer nga Artor Ylli”.

29.4. Komisioni ka konstatuar shumën të ndryshme²⁷ për transaksionet, si më poshtë:

- a) në datën 14.12.2010, në vlerën 16000 USD, me përfitues z. Zh.;
- b) në datën 13.02.2012, në vlerën 30000 USD, me qëllim shlyerje detyrimi; dhe
- c) në datën 02.11.2010, transfertë *cash* në vlerën 10000 USD, me përfitues z. Zh., me qëllim shlyerje detyrimi.

30. Për sa i përket vlerës provuese, deklaratat e dhëna nga z. N.M. bien ndesh me kufirin e lejimit të provave me dëshmitar, sipas përcaktimit të nenit 231 të K.Pr.Civile, sipas të cilit: “Prova me dëshmitarë lejohet në të gjitha rastet, përveç kur ligji për vlefshmërinë ose provimin e një veprimi juridik kërkon shkresë”, si dhe me përcaktimin e nenit 232 të K.Pr.Civile, sipas të cilit: “Nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë [...]”.

²⁵ Neni 7, pika 2 e rregullores së Bankës së Shqipërisë nr. 64, datë 30.7.2003, përcaktonte se: “Çdo individ ka të drejtë të transferojë lirisht nga brenda-jashtë territorit të Shqipërisë ekuivalenten në çdo monedhë tjetër të shumës deri në 3,5 milionë lekë, sipas kursit të ditës, dhe brenda afatit kohor të një viti kalendarik [...]”.

²⁶ Pikat 1 dhe 3 të vendimit nr. 70, datë 30.09.2009, përcaktojnë se: “1. Transferimi i kapitalit nga jashtë-brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nga rezidentët dhe jorezidentët kryhet lirisht dhe pa kufizime. [...] 3. Subjektet e licencuara kryejnë transferimin e kapitalit nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të klientëve të tyre pas plotësimit të dokumentacionit të përcaktuar si më poshtë, si dhe dokumenteve të tjera shtesë që subjektet mund të çmojnë të arsyeshme: a) për personat fizikë tregtarë dhe juridikë: i) deklarimi i qëllimit të transferimit të kapitalit dhe i burimit të krijimit të kapitalit që transferohet, shuma e kapitalit që kërkohet të transferohet jashtë Shqipërisë dhe adresa ku do të transferohet, ii) vendimi i organit vendimmarrës të klientit për kryerjen e transferimit të kapitalit, iii) ekstrakti i regjistrimit tregtar, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, iv) vërtetimi nga zyra e tatim-taksave, për shlyerjen e të gjitha detyrimeve fiskale ndaj shtetit. b) për personat fizikë: i) deklarimi i qëllimit të transferimit të kapitalit, deklarimi i burimit të krijimit të kapitalit që transferohet, shuma e kapitalit që transferohet jashtë Shqipërisë dhe adresa ku do të transferohet”.

²⁷ Diferencat janë për komisionet e mbajtura, shumën e transferuara janë 16.000, 30.000 dhe 10.000.

30.1. Sipas nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9920/2008”): “1. Shitësi lëshon faturë tatimore dhe blerësi duhet ta kërkojë atë në kohën e realizimit të shitjes apo të kryerjes së punimit ose shërbimit. Fatura tatimore përgatitet nga shitësi në jo më pak se dy kopje, nga të cilat njërën e merr dhe e ruan blerësi, kurse tjetrën e mban dhe e ruan shitësi. Faturat përgatiten me numër rendor progresiv”.

30.2. Pika 46.1.10 e udhëzimit të ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008, i ndryshuar (në vijim “udhëzimi i ministrit të Financave nr. 24/2008”), përcakton se: “Për mallrat e importuara nga jashtë vendit, që transportohen nga dogana ku zhdoganohet malli në drejtim të magazinës së personit të tatuëshëm importues, si dokument për lëvizjen e mallit do të shërbejë deklarata doganore e importit e lëshuar nga administrata doganore, shoqëruar edhe me faturën e lëshuar nga furnitori i huaj i mallit. Në raste furnizimesh të mëdha, ku për lëvizjen e mallit nga dogana në magazinën apo magazinat e personit të tatuëshëm importues, kërkohen disa mjete dhe ngarkesa transporti, si dokument për lëvizjen e mallit do të shërbejë një dokument shoqërimi i mallit si fatura e shoqërimit kur mund të lëshohet nga importuesi për çdo mjet transporti dhe për çdo ngarkesë ose një dokument i lëshuar nga agjencia speditonere ose agjencia doganore për çdo mjet transporti dhe për çdo ngarkesë, së bashku me një fotokopje të deklaratës doganore të importit dhe të faturës së lëshuar nga furnitori i huaj i mallit”.

31. Trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se deklaratimet e z. N.M., për të vërtetuar një marrëdhënie tregtare për të cilën ligji tatimor ka përcaktuar dokumente tatimore/doganore, është në kundërshtim me nenin 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2006, i cili përcakton se: “4. Komisioni dhe Kolegji i Apelitimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. [...]”, dhe njëkohësisht deklaratimet e z. N.M. bien ndesh me kufirin e lejuar të provueshmërisë me dëshmitarë.

31.1. Duke iu referuar shkresës nr. {***} prot., datë 10.07.2018, të DRT Tiranë, për periudhën 2010-2014, subjekti i rivlerësimit kishte qarkullim e fitim “0” lekë.

31.2. Për këtë arsye, për shumat e transferuara nëpërmjet {***}-së, siç specifikohet në dokumentet zyrtare të marra nga banka, në datën 14.12.2010, në vlerën 16000 USD, me përfitues z. Zh., në datën 13.02.2012, në vlerën 30000 USD, me qëllim “borxh” dhe në datën 02.11.2010, transfertë *cash* në vlerën 10000 USD, me përfitues z. Zh., me qëllim shlyerje detyrimi nga subjekti i rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pagesave të kryera, sipas përcaktimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe, në këto kushte, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas përcaktimit të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016²⁸.

32. Për sa i përket konkluzionit të arritur nga Komisioni për kryerjen e evazionit tatimor nga subjekti i rivlerësimi për llogari të biznesit të familjarëve të z. N.M., trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se sipas përcaktimeve të nenit 116²⁹ të ligjit nr. 9920/2008, evazoni tatimor është nën juridiksionin

²⁸ Neni 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, përcakton se: “1. Konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet e mëposhtme: a) kur arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; b) kur arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; c) kur arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale”.

²⁹ Neni 116, “Evazoni tatimor”, i ligjit nr. 9920/2008, përcakton se: “1. Fshehja apo shmangia nga pagimi i detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mosdeklarimit të të dhënave të nevojshme, sipas legjisllacionit në fuqi, dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara apo deklaratave ose informacioneve të rreme, që çojnë

e administratës tatimore, dhe kur vërtetohen rastet e përcaktuara nga neni 131³⁰ i ligjit nr. 9920/2008, mund të përbëjë edhe vepër penale, që është nën juridiksionin e organit të prokurorisë në përputhje me legjislacionin penal.

32.1. Institucionet e rivlerësimit kanë kompetencë që faktet e konstatuara gjatë procedurës së vlerësimit të pasurisë, sikurse në rastin konkret, të merren në shqyrtim brenda objektit të vlerësimit të pasurisë, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, në drejtim të deklaramit dhe kontrollit të pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, duke përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

- 33.** Në lidhje me shtrirjen kohore të transfertave të mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ato shtrihen në një periudhë kur subjekti i rivlerësimit nuk ushtronte funksionin e ndihmësit ligjor, për shkak të të cilit *ex officio* i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, dhe se në deklaratën *vetting* vlera në shifra ka qenë “0” lekë.

33.1. Referuar jurisprudencës së Kolegjit, në lidhje me këtë konstatim, Kolegji i Apelit ka arsyetuar se: “Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues çmon se referuar nenit Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, rivlerësimi i subjekteve për kriterin e kontrollit të pasurive kryhet nga organet e rivlerësimit, në përputhje me përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të ligjit nr. 84/2016.” – dhe se: “Në kuptim të dispozitës së sipërcituar kushtetuese dhe Kreut IV të ligjit nr. 84/2016, çdo pasuri, sipas kuptimit të dhënë në nenin 3, pika 11 e ligjit të rivlerësimit, që është objekt deklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting*, i nënshtrohet kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, saktësinë e deklaramit dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë dallim dhe kufizim, i artikuluar ky sipas kriterit të kohës së krijimit apo çdo lloj kriteri tjetër përcaktues”³¹. Gjithashtu, duke iu referuar jurisprudencës së Kolegjit, *standardi i vendosur nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 30 i ligjit nr. 84/2016, kërkon që subjekti të shpjegojë bindshëm jo vetëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara, por edhe ligjshmërinë e të ardhurave, të cilat duhet të jenë të krijuara nga burime të ligjshme, të jenë të deklaruara dhe për to të jenë paguar detyrimet tatimore përkatëse.*³²

në përlllogaritjen e pasaktë të shumës së tatimit, taksës apo kontributit, përbën evazion tatimor dhe dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të diferencës së shumës së përlllogaritur nga ajo që duhet të ishte në fakt. 2. Në kuptim të pikës 1, të këtij neni, konsiderohet gjithashtu se kryejnë evazion tatimor duke kryer fshehje të të ardhurave, me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi i detyrimeve tatimore, tatimpaguesit, për të cilët konstatohet se kryejnë këto shkelje dhe për të cilët janë aplikuar dënimet administrative në përputhje me: a) pikën 1, të nenit 119, të këtij ligji, b) pikën 3, të nenit 121, të këtij ligji; c) pikën 1, shkronjat “a” e “b”, të nenit 122, të këtij ligji”.

³⁰ Neni 131, “Veprat penale”, i ligjit nr. 9920/2008, përcakton se: “Personi, i cili, për çdo tatim të vendosur nga një ligj tatimor, kryen ndonjërin nga veprat që vijojnë, dënohet në përputhje me Kodin Penal kur: a) me dashje përpiqet të kryejë evazion tatimor; kryen evazion tatimor siç parashikohet në pikën 2, të nenit 116, të këtij ligji. me dashje nuk mbledh tatimin ose nuk e paguan atë në buxhet; me dashje nuk mbledh detyrimin tatimor dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ose nuk i paguan ato në buxhet; me dashje fsheh ose shkatërron libra dhe regjistrime, dokumente, deklarata apo informacion tjetër të rëndësishëm për detyrimin tatimor; ç) me dashje dorëzon dokumente, deklarata tatimore ose informacion të falsifikuar; c) me dashje nuk i bindet një kërkese me shkrim për t’u paraqitur në organet tatimore; me dashje ndërhyt në vlerësimin ose mbledhjen e tatimit; kërcënon ose kryen shkelje ndaj një zyrtari tatimor; në bashkëpunim me një zyrtar tatimor, paguan ose pranon ryshfete; i ofron ryshfet një zyrtari tatimor; me dashje jep informacion tatimor në mënyrë të paautorizuar me ligj ose rregullore. Administrata tatimore bën kallëzim penal në prokurori për çdo shkelje të parashikuar në pikën 1 të këtij neni”.

³¹ Shih pikën 20.4 të vendimit nr. 6 datë 28.02.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

³² Shih pikën 22.13 par. i fundit të vendimit nr. 19 datë 26.07.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

33.2. Sipas përcaktimeve të nenit 3, pikat 11 dhe 19 të ligjit nr. 84/2016 dhe të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), dhe që janë pjesë e formularit të deklaratës *vetting*, objekti i deklarimit janë të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur. Duke listuar pasuritë që janë objekt deklarimi, sipas përcaktimeve të mësipërme ligjore, ato rezultojnë si më poshtë:

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, në pronësi dhe në përdorim të subjektit të rivlerësimit;
- b) pasuritë e paluajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to, të cilat janë në proces dhe në përdorim të subjektit të rivlerësimit;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300.000 lekë;
- ç) vlera e aksioneve, e letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlera e likuiditeteve, gjendja *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj, brenda dhe jashtë vendit.

34. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se gjendja në llogari bankare i nënshtrohet kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, saktësinë e deklarimit dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë dallim dhe kufizim, i artikuluar ky sipas kriterit të kohës së krijimit apo çdo lloj kriteri tjetër përcaktues, pavarësisht se në atë periudhë kohore subjekti i rivlerësimit nuk ushtronte funksionin e ndihmësit ligjor, sipas përcaktimeve ligjore (neni 3, pikat 11 dhe 19 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003), ky ka qenë qëndrimi i Kolegjit edhe më herët në rrethana të ngjashme.³³

35. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i kontestuar i Komisionit ka çuar në etiketim të papërshtatshëm dhe stigmatizim të subjekti të rivlerësimit. Duke referuar në përdorimin e shprehjes së Komisionit se *kjo për faktin se veprimet e kryera nga subjekti si nga mënyra dhe shkaku janë cilësi të karakterit të subjektit, të cilat nuk mund të mësohen në asnjë institucion edukimi, por janë cilësi individuale të personit*, subjekti i rivlerësimit shprehet se asnjë karakteristikë e individit, e lindur apo e përfutur, nuk duhet të shërbente si bazë për përjashtim apo kufizim të pajustificuar të të drejtave të tij, duke qenë se është paragjyqese, dhe se nuk përputhet me aktet e dosjes. Në nenin 14 të KEDNj-së, shprehet subjekti i rivlerësimit, përcaktohet se respektimi i të drejtave dhe lirive të njohura në KEDNj, duhet të bëhet pa asnjë diskriminim në çfarëdo baze, siç janë: gjinia, raca, ngjyra, religjioni, bindja politike, prejardhja nacionale ose shoqërore, përkatësia e pakicave nacionale, pronësia, lindja ose simbolet tjera. Për këtë qëllim, përdorimi i një diskursi diskriminues, sipas subjektit të rivlerësimit, do të ishte e preferueshme të shmangej në vazhdimin e terminologjisë së papërcaktuar, e cila, me sa duket, sipas tij, shpreh një këndvështrim krejt personal dhe paragjyqes të Komisionit ndaj subjektit të rivlerësimit. Komisioni, vijon subjekti i rivlerësimit, nuk mund të spekulonte për *sjelljen* dhe *integritetin* e tij si asistent avokat dhe më pas si avokat, pasi spekulimi i tyre nuk mbështetet në aktet e dosjes. Kjo pjesë e vendimit të Komisionit, sipas subjektit të rivlerësimit, lidhur me cilësinë e karakterit të subjektit të rivlerësimit, *etikën* dhe *integritetin* moral të tij, është paragjyqese dhe në të njëjtën kohë fyese pasi për *etikën* dhe *integritetin* moral të tij flasin dokumentet konfirmuese nga DhKASh dhe GjAShP Tiranë.

³³ *Shih vendimin nr. 6, datë 28.02.2019 dhe nr. 19, datë 26.07.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.*

35.1. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se është në kompetencën e Komisionit apo Kolegjit që të çmojë në tërësi çdo indicie lidhur me rrethanat e çështjes, vlerësimi i të cilave nga ana tjetër, duhet të jetë në përputhje me përcaktimet ligjore, sipas nenit 4, pika 1 e Kushtetutës, dhe nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.³⁴ Për më tepër, subjekti i rivlerësimit nuk ka shtjelluar mbi ç'bazë e ka diskriminuar Komisioni dhe pse mendon që konkluzioni i Komisionit është i asociuar me një nga cilësitë e përhershme individuale të mbrojtura nga neni 14 i KEDNj-së, sikurse gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, gjuha, besimi fetar, mendimi politik, origjina etnike apo shoqërore, përkatësia në një pakicë kombëtare, pasuria, lindja apo status tjetër. Ky argument i subjektit të rivlerësimit është i pashtjelluar dhe i paarsyetuar, dhe për pasojë është e pavend për Kolegjin të spekulojë çfarë ka pasur parasysh subjekti i rivlerësimit me këtë pretendim. Për më tepër, neni 14 i KEDNj-së u referohet karakteristikave të përhershme ose të pandashme nga një individ, të cilat mbrohen nga shtetet kontraktuese dhe asocimi i cilësdo prej tyre me vendimin e Komisionit për këtë subjekt rivlerësimi do të ishte sjellje joetike.

35.2. Sjellja e subjektit të rivlerësimit, gjatë ushtrimit të funksionit apo jashtë tij, apo edhe gjatë procesit të rivlerësimit, çmohen bazuar në përcaktimet e ligjit të posaçëm *lex specialis* (nenit 48 të ligjit nr. 84/2016), dhe për aq sa ai referon në nenet 3 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016.

35.3. Etika dhe integriteti maten bazuar në treguesit e përcaktuar për kriterin e vlerësimit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave gjyqësore (neni 40 i ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 71 e 75 të ligjit nr. 96/2016).

35.4. Për këto arsye, etika dhe integriteti i rivlerësimit janë vlerësuar brenda procedurës së aftësive profesionale, duke u bazuar edhe në dokumentet konfirmuese nga DhKASH dhe GjASHP Tiranë, sipas përcaktimeve të nenit 40 të ligjit nr. 84/2016 dhe neneve 71 e 75 të ligjit nr. 96/2016, por jo edhe sjellja e subjektit të rivlerësimit, jashtë funksionit dhe gjatë procesit të rivlerësimit, si pasojë e rrethanave që kanë rezultuar nga procedura e vlerësimit të pasurisë.

36. Përfundimet në të cilat arrin Komisioni, shprehet subjekti i rivlerësimit, lidhur me veprimet e tij për transfertat bankare në mënyrë të përsëritur, të pajustificuara me burime të ligjshme, tregojnë një mungesë të theksuar të përmbushjes së vlerave themelore që duhet të udhëheqin një magjistrat të ardhshëm, nuk vlejnë për rastin e tij sepse, *së pari*, referuar shkronjës “gj” të nenit 2 të ligjit nr. 96/2016, magjistrat është gjyqtari, me përjashtim të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, prokurori dhe kryetari në kuptim të shkronjës “g” të këtij neni. Konkretisht, vijon subjekti i rivlerësimit, në nenin 3 dhe në nenin 4 të ligjit nr. 96/2016, përcaktohen vlerat themelore, të drejtat, detyrimet dhe standardet e sjelljes për magjistratët gjatë kohës kur ata janë në detyrë, përfshirë dhe veprimtaritë e kryera kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare, dhe ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk gëzon statusin e magjistratit nuk mund të jetë ligji nr. 96/2016 dhe dispozitat e tij, ligj i aplikueshëm për vlerësimin e etikës dhe integritetit të tij. *Së dyti*, shprehet subjekti i rivlerësimit, Komisioni në vendim gjithashtu ka konkluduar se fakti që ka kryer disa transaksione në emër të z. N.M. është një shkelje etike e rregullave të sjelljes së gjyqtarit, por ai jo vetëm që nuk ka qenë gjyqtar në atë kohë, por edhe si asistent avokat nuk ka asnjë rregull që ndalon një person të veprojë në mirëbesim, dhe se ky ka qenë pikërisht rasti, sipas tij. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka vepruar në mirëbesim pa qenë në dijeni të ndonjë qëllimi nga ana e z. N.M., pa u paguar asnjëherë për këto transaksione. Kjo, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk e bën lehtësues të evazionit fiskal, pasi nuk ka pasur asnjëherë dijeni dhe nuk ka asnjë provë, madje për një qëllim

³⁴ Neni 4, pika 1 e Kushtetutës përcakton: “1. E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit”.

të tillë potencial të këtyre transaksioneve. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, arsyeton se sa më sipër përbëjnë shkelje të cilat “nuk ka shkollë t’i korigjojë”, dhe se në mendimin e tyre njerëzit linden të tillë, dhe për këtë, vijon, mbase nuk është në gjendje të gjejë fjalët e duhura për të thënë se sa e gabuar në çdo nivel të mundshëm është një thënie e tillë, dhe diskriminimi duket pikërisht këtu.

36.1. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes janë në themel të forcimit dhe mbrojtjes së besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, dhe rikthimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë përbën shkakun ligjor, për të cilin subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar këtij procesi. Për këtë arsye, vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes nuk janë të zbatueshme vetëm për magjistratët e emëruar dhe të caktuar në detyrë, por edhe për subjektet e rivlerësimit që janë në proces të përgatitjes për magjistratë të ardhshëm.

37. Sipas subjektit të rivlerësimit, në vendimin e tij Komisioni ka evidentuar se ky i fundit pranon se i ka kryer këto transfertë në vitet 2010–2012 dhe në vite të tjera, deri në janar të vitit 2015, ka transferuar jashtë vendit në çdo rast shumën e lejuar prej 3,5 milionë lekësh, duke e ditur që ky ishte një veprim i cili favorizonte biznesin e z. N.M., duke kryer evazion tatimor. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, ka avancuar në mënyrën më të paimagjinueshme, duke ndryshuar edhe deklaratimet e tij si subjekt rivlerësimi, të dhëna përgjatë komunikimit elektronik me Komisionin. Ky, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk është deklarimi i tij, por është një pjesë nga komunikimi që ka pasur Komisioni me dëshmitarin, z. N.M., dhe se këtij të fundit i kanë ndryshuar përsëri deklaratimet. Subjekti i rivlerësimit vijon se arsyetimi trupit gjykues që transfertë si asistent avokat ishte një veprim i cili favorizonte biznesin e z. N.M., duke kryer evazion tatimor, vjen në kundërshtim me jurisprudencën e “Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë”, pasi kjo e fundit ka jurisprudencë të konsiderueshme duke interpretuar testin ndërgjegjësimit ose njohuri në vendimet e tjera të gjykatës dhe kujdesin që gjykata merr për ngritjen e një prove të kësaj natyre. Për shembull, vijon subjekti i rivlerësimit, në rastin e gjenocidit të Bosnjës, gjykata u shpreh: “por çfarëdo qoftë përgjigjja ndaj kësaj pyetjeje, nuk ka dyshim se sjellja e një organi ose personi që i jep ndihmë një autori të veprës penale të gjenocidit nuk mund të trajtohet me vetëdije, që do të thotë në veçanti ishte në dijeni të qëllimit specifik *dolus specialis* të kryerësit kryesor”. Në vijim, subjekti i rivlerësimit shprehet se me ndryshimin e deklaratimeve të tij dhe me arritjen e përfundimeve se ka kryer evazion tatimor si asistent avokat i shtetasit N.M., Komisioni ka shprehur opinion parajgykues ndaj tij, pasi ai nuk mund të kishte dijeni për qëllimin specifik *dolus specialis*, pse avokati ku ai punonte e përdori për këtë transfertë. Duke mos njohur parimet më themelore të legjislacionit ndërkombëtar për një çështje të tillë, shprehet subjekti i rivlerësimit, dy komisionerët, me arsyetimin e tyre, kanë kryer shkelje të rënda të Kushtetutës dhe të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Rezulton, sipas subjektit të rivlerësimit, se sipas nenit 179/b, pika 1 e Kushtetutës, sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksioni i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si dhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi, dhe se sipas pikës 2 të këtij neni rivlerësimi do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të tij, të cilat në rastin e tij janë cenuar nga vendimi i Komisionit.

37.1. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka avancuar në mënyrën më të paimagjinueshme, duke ndryshuar edhe deklaratimet e tij si subjekt rivlerësimi, të dhëna përgjatë komunikimit elektronik me Komisionin, trupi gjykues i Kolegjit konstaton:

- a) në paragrafin 1.32, Komisioni arsyeton se: “1.32. Subjekti i rivlerësimit pranon se i ka kryer këto transferta në vitet 2010-2012 dhe në vite të tjera deri në janar të vitit 2015, ka transferuar jashtë vendit në çdo rast shumën e lejuar prej 3,5 milionë lekësh, duke e ditur që ky ishte një veprim i cili favorizonte biznesin e z. N.M., duke kryer evazion tatimor”;
- b) në faqen 1, pika 2 e aktit kthim përgjigjeje nga subjekti i rivlerësimit, në vijim të komunikimit elektronik, datë 05.07.2018, nga Komisioni, shprehimisht rezulton: “2. Përfitoj nga rasti, t’ju konfirmoj se mbi transfertën në llogari, unë kam vepruar për llogari të shtetasit N.M. dhe në këtë cilësi për të vepruar si përfaqësues i autorizuar i tij në lidhje me këtë veprim, kam kryer stazhin e asistent avokatit pranë këtij të fundit (Profesor N.M. është avokat me të drejtë ushtrimi të profesionit në Republikën e Shqipërisë dhe zv/ректор i Kolegjit Universitar {***}, me gradën shkencore Doktor në drejtësi. Unë kam vepruar në këtë cilësi në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, rregulloren “Për veprimtarinë valutore”, miratuar me vendimin nr. 70, datë 30.09.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë (shiko deklaratën e z. N.M. të datës 6.7.2018, sipas aneksit nr. 1, bashkëngjitur kësaj shkrese)”;
- c) nga deklarata e datës 06.07.2018 e z. N.M., rezulton shprehimisht: “Unë N.M.M., ID {***}, adresa rr. “{***}”, {***}, Tiranë, banesë private, deklaroj me përgjegjësi ligjore se më datë 14 dhjetor 2010 dhe më datë 13.02.2012, z. Artor Ylli ka transferuar për llogarinë time, në {***} (shumën 16050 USD dhe 30080 USD) në drejtim të Republikës Popullore të Kinës, për z. Zh. Sipas rregullave bankare deri në fund të vitit 2014, çdo shtetas shqiptar lejohej si individ të transferonte shumën deri në 3,5 milion lekë (ose ekuivalente me këtë shumë), brenda një viti kalendarik”;
- ç) nga deklarata datë 13.08.2018 e z. N.M., rezulton shprehimisht: “Unë N.M.M., ID {***}, adresa rr. “{***}”, {***}, Tiranë, jo vetëm në vitin 2010 dhe 2012, por edhe në vite të tjera, deri në janar 2015, kam transferuar pothuajse në çdo rast shumën e lejuar si shtetas shqiptar, prej 3,5 milionë lekësh. Por detyrimet që kisha në Kinë, nga blerja e mallrave, ishin më të mëdha se 3,5 milion lekë, prandaj këto diferenca të shumave të detyrimeve janë kryer nga Artor Ylli”.

37.2. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni nuk ka ndryshuar deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, sikurse subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni *ka avancuar në mënyrën më të paimagjinueshme duke ndryshuar edhe deklaratimet e tij si subjekt rivlerësimi të dhëna përgjatë komunikimit elektronik*, por se Komisioni ka kryer një përmbledhje të deklaratimeve të subjektit që ai vetë ka paraqitur në Komision, sikurse edhe të deklaratimit të mëvonshëm të z. N.M.

37.3. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson gjithashtu se nuk është në përputhje me rrethanat e çështjes referimi që subjekti i rivlerësimit ka bërë te jurisprudenca e GjND-së, pasi subjekti i rivlerësimit në çështjen konkrete nuk i ka dhënë ndihmë një autori të veprës penale të gjenocidit, por ka kryer veprime që cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, për shkak se kryerja e transaksioneve bankare në funksion të atyre tregtare, në kundërshtim me legjislacionin tatimor, nuk është në përputhje me vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes. Referimi nga subjekti i rivlerësimit në përkufizimin e zhvilluar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, sa i përket qëllimit të kryerjes së gjenocidit, krimi më i rëndë i kryer në historinë e njerëzimit, në një çështje ku debatohet nëse është kryer evazion fiskal, në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, një proces administrativ, tregon së paku mungesë ndërgjegjësimit dhe

gjykimi për peshën e rëndë që ka pasur kjo vepër në jetën e popujve, apo edhe mungesë respekti për miliona viktimat e gjenocidit.

38. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit ka shkelur të drejtat e tij, të garantuara me nenin 179/b të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së. Parimi i shtetit të së drejtës, sipas subjektit të rivlerësimit, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj efekteve të tjera normative, çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për atë që sa i lejon Kushtetuta dhe ligji, duke mos i tejkalar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, vijon subjekti i rivlerësimit, Komisioni duke zgjeruar rastin e shkarkimit nga detyra dhe me vlerësimin tërësor të procedurave apo cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, të cilat janë nocione të papërkufizuara sipas tij, kanë përdorur standarde të papërkufizuara dhe të panjohura për legjislacionin shqiptar. Për rrjedhojë, vendimmarrja nga Komisioni ka shkaktuar trajtim të pabarabartë të subjektit të rivlerësimit, pasi procesi i rivlerësimit ndaj tij pretendon se është bërë si avokat dhe jo si ndihmës ligjor pranë gjykatës administrative, çka bie ndesh me nenet 18 dhe 179/b të Kushtetutës. Kushtetuta, vijon subjekti i rivlerësimit, në nenin 18 të saj parashikon se të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit, dhe ky diskriminim ligjor bie ndesh me nenin 18 të Kushtetutës, si dhe me aktet ndërkombëtare që përcaktojnë parime dhe rregulla lidhur me ushtrimin e detyrës së avokatit, të tilla si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (neni 2, pika 1), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (neni 26), Konventa Evropiane e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (neni 1 i Protokollit shtesë nr. 12), të cilat ndalojnë diskriminimin, duke përfshirë edhe rastet e diskriminimit për shkak të profesionit. Rekomandimi R (2000) 21 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës ndaj shteteve anëtare mbi lirinë për të ushtruar profesionin e avokatit (hyrë në fuqi më 25.10.2000) parashikon se “me dëshirën për të promovuar lirinë e ushtrimit të profesionit të avokatit për të forcuar sundimin e ligjit në të cilin avokatët janë pjesë në mënyrë të veçantë në rolin për të mbrojtur liritë individuale, të vetëdijshëm për nevojën për një sistem të drejtë të administrimit të drejtësisë, i cili garanton pavarësinë e avokatëve në kryerjen e detyrave të tyre profesionale pa asnjë kufizim të papërshtatshëm, ndikim, nxitje, presion, kërcënim ose ndërhyrje, direkte apo indirekte në çdo person [...]. Parimi I – Parimet e përgjithshme për lirinë e ushtrimit të profesionit të avokatit – duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të respektuar, mbrojtur dhe promovuar lirinë e ushtrimit të profesionit të avokatit, pa diskriminim dhe pa ndërhyrje të papërshtatshme nga autoritete publike, veçanërisht në dritën e dispozitave përkatëse të KEDNj-së”.

38.1. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni nuk ka tejkalar kufijtë e përcaktuar me ligj dhe as ka zgjeruar rastin e shkarkimit, pasi vlerësimi tërësor i procedurave është përcaktim ligjor sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dhe sikurse në çështjen konkrete rezultojnë rrethana që cenojnë vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes, jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra sipas përcaktimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit, si edhe në rastin e pretendimit të nenit 14 të KEDNj-së, edhe në pretendimin për shkeljen nga Komisioni të nenit 2 të Deklaratës Universale, nenit 26 të Konventës për të Drejtat Sociale dhe Politike, nuk shpjegon se si ka ndodhur kjo shkelje dhe cilat karakteristika të tij të mbrojtura posaçërisht nga këto standarde ndërkombëtare, janë shkelur nga Komisioni në procesin e rivlerësimit apo cilat veprime të Komisionit provojnë këto shkelje në rastin e tij.

38.2. Gjithashtu, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se besimi i publikut nuk është nocion i papërkufizuar, por se ai gjen mbështetje te vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së magistratëve, sipas përcaktimeve të neneve 3 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016

38.3. Subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, që është doemos i fokusuar në të shkuarën e subjekteve të rivlerësimit, për shkak të funksionit të ndihmësit ligjor, dhe për këtë arsye është i pabazuar pretendimi se është objekt diskriminimi ligjor për shkak të profesionit. Ushtrimi i profesionit të avokatit nga ana e subjektit të rivlerësimit, nuk është në objektin e shqyrtimit të kësaj çështjeje.

39. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi cenon parimin e sigurisë juridike sepse teksti i tij është i paqartë, konfuz dhe në raste të caktuara edhe kontradiktor, dhe se vendimi ka krijuar një situatë paqartësie, e cila ka passjellë shkarkimin nga detyra si ndihmës ligjor të subjektit të rivlerësimit, pasi i është referuar ligjit nr. 96/2016, i cili është ligj me natyrë të përgjithshme që rregullon statusin e magistratëve, duke parashikuar rregulla sjelljeje në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e magistratëve, pranimin dhe emërimin e tyre, zhvillimin e karrierës deri në mbarimin e statusit, dhe se nga ana tjetër ligji nr. 84/2016 që gjen bazën kushtetuese në Aneksin e Kushtetutës, është një ligj i posaçëm *sui generis* për vetë faktin se rregullon një disiplinë specifike dhe me zbatim të kufizuar në kohë. Kjo natyrë specifike, shprehet subjekti i rivlerësimit, theksohet që në nenin 1 të ligjit nr. 84./2016, i cili parashikon se *ky ligj ka për qëllim përcaktimin e rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjitha subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut te institucionet e këtij sistemi*, dhe duke vijuar subjekti i rivlerësimit shprehet se dispozitat e ligjit nr. 84/2016 përcaktojnë parimet, metodologjinë, procedurat dhe standardet e rivlerësimit, si dhe organizimin e institucioneve të rivlerësimit, dhe se nga ana tjetër ligji nr. 96/2016 është ligji i pakufizuar në kohë dhe ka për objekt rregullimin e të drejtave, detyrimeve, vlerësimit, emërimin dhe mbarimin e statusit të magistratit, si dhe përgjegjësitë disiplinore të magistratëve. Si pasojë, sipas subjektit të rivlerësimit, raporti midis dispozitave të marra në analizë, specifikuar më sipër, shihet në dritën e parimit *lex specialis derogat lex generali*. Parimi i sigurisë juridike, thekson subjekti i rivlerësimit, përfshin krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore, dhe se besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Parimi i shtetit të së drejtës ku mbështet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Vendimi, pretendon subjekti i rivlerësimit, është marrë në kundërshtim me parimet ndërkombëtare në lidhje me pavarësinë dhe përgjegjësinë e gjyqtarëve, avokatëve, prokurorëve, miratuar nga Komisioni i Tetë Ndërkombëtar i Juristëve në fillim të vitit 2004 (versioni më i ri është ai i 22.06.2009), i cili përmban shumë dokumente të rëndësishme dhe relevante ndërkombëtare. Parimet bazë të rolit të juristëve, vijon subjekti i rivlerësimit, (miratuar nga Kongresi i Tetë i Kombeve të Bashkuara për parandalimin e krimit dhe trajtimin e shkelësve, mbajtur në Havana, Kubë, më 27 gusht deri më 7 shtator) parashikon në veçanti se *qeveritë duhet të sigurojnë që avokatët: a) janë në gjendje të kryejnë të gjitha funksionet e tyre profesionale pa frikë pengese, ngacmim apo ndërhyrje të pahijshme; b) janë në gjendje të udhëtojnë dhe të konsultohen me klientët e tyre lirisht si brenda vendit, edhe jashtë vendit; dhe c) nuk do të vuajnë ose do të*

kërcënohen me ndjekje penale apo administrative sanksione ekonomike apo pasoja të tjera për çdo veprim të ndërmarrë në përputhje me detyrat e njohura profesionale, standardet dhe etikën. Qeveritë duhet të njohin dhe të respektojnë të gjitha komunikimet dhe konsultimet ndërmjet avokatëve dhe klientëve të tyre në kuadër të marrëdhënieve të tyre profesionale, të cilat janë konfidenciale”. Siç është theksuar në paragrafin 1.1 të Kodit të Sjelljes për Avokatët Evropianë CCBE, referon subjekti i rivlerësimit, respekti për funksionimin profesional të avokatit është një kusht thelbësor për shtetin e së drejtës dhe demokracinë në shoqëri, dhe se në lidhje me avokatët subjekti i rivlerësimit referon në paragrafin 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Kodit CCBE të Sjelljes për Avokatët Evropianë, sipas të cilëve *një avokat i cili merr pjesë në një rast para një gjykate duhet të jetë në përputhje me rregullat e aplikuara para kësaj gjykate apo tribunali, një avokat duhet, duke ruajtur respektin e duhur dhe mirësjelljen ndaj gjykatës, të mbrojë interesat e klientit me nder dhe pa frikë, pa marrë parasysh interesat e veta ose ndonjë pasojë të tij apo saj apo të ndonjë personi tjetër, avokati nuk duhet të japë me vetëdije informacion të rremë ose mashtrues në gjykatë.* Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pretendon se gjatë kohës që ka qenë avokat, ka respektuar Kodin Etik të Avokatit, pasi vlerëson se ai ishte kodi i tij për sjelljen profesionale, dhe se ka vepruar në pajtueshmëri me ligjin, sekretin profesional, integritetin dhe dinjitetin, respektin për palët, kompetencën, drejtësinë dhe për këtë fakt, sipas tij, flasin dokumentet nga DhKASH.

39.1. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se vendimi i Komisionit është i qartë në përmbajtje, pasi fillimisht renditen në vendim faktet që Komisionit i rezultuan nga hetimi administrativ, dhe pasi në vendimin e Komisionit jepet referenca ligjore, ky i fundit ka arritur në pasojën e masës disiplinore të shkarkimit, ndërkohë që trupi gjykues nuk vëren kontradikta në vendim, sikurse subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni i është referuar ligjit nr. 96/2016, i cili është ligj me natyrë të përgjithshme, dhe nga ana tjetër ligji nr. 84/2016 që gjen bazën kushtetuese në Aneksin e Kushtetutës, është një ligj i posaçëm.

39.2. Gjithashtu, trupi gjykues i Kolegjit çmon si të pabazuar pretendimin se është cenuar parimi i sigurisë juridike nën dritën e parimit *lex specialis (ligji nr. 84/2016) derogat lex generalis (ligji nr. 96/2016)*, pasi këto ligje plotësojnë njëri-tjetrin dhe nuk ekziston përplasja ndërmjet tyre. Ligji nr. 84/2016 është një ligj i posaçëm që synon rikthimin e besimit të publikut, ndërsa ligji nr. 96/2016 është një ligj që synon garantimin dhe mbrojtjen e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, nëpërmjet respektimit të vlerave themelore dhe standardeve dhe rregullave të sjelljes. Vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes nga ana tjetër, nuk janë të zbatueshme vetëm për magjistratët e emëruar dhe të caktuar në detyrë, por edhe për subjektet e rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ka dështuar të shpjegojë se si vendimi i Komisionit përbën cenim të pavarësisë së profesionit të avokatisë, duke konstatuar sjellje joetike nga ana e subjektit të rivlerësimit apo evazion fiskal.

39.3. Nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit *se për sekretin profesional, integritetin dhe dinjitetin, respektin për palët, kompetencën, drejtësinë, flasin dokumentet nga DhKASH*, pasi DhKASH dhe dokumentet e saj janë vetëm një prej burimeve që vlerësohet gjatë procesit të rivlerësimit, në tërësinë e të gjitha burimeve të tjerave përgjatë procedurave të vlerësimit të pasurive, kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

40. Sipas subjektit të rivlerësimit, konkluzionet e nxjerra nga ana e Komisionit lidhur me këto transferta, bien ndesh me njëri-tjetrin dhe kanë tendencën të rëndojnë pozitën e subjektit, pasi nga njëra anë pretendojnë se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm se shumat që ai ka transferuar në llogari të z. Zh. në Republikën e Kinës ishin bërë për qëllim tregtar, për blerje

mallrash për nevoja të shtetasit N.M., dhe nga ana tjetër arrijnë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit pranon se ka transferuar jashtë vendit në çdo rast shumën e lejuar prej 3,5 milionë lekësh, duke e ditur që ky ishte një veprim i cili favorizonte biznesin e z. N.M., duke kryer evazion tatimor. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, ka cenuar standardin e arsytimit të vendimit si pjesë të rëndësishme e procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, vijon subjekti i rivlerësimit, domosdoshmëria e arsytimit të Komisionit, është një garanci për procesin ligjor, dhe funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë në këtë drejtim, dhe se vendimi i Komisionit, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk është logjik, është i çrregullt në formë dhe i paqartë në përmbajtje, dhe se argumentet e pjesës arsyetuese nuk janë të bazuara dhe të lidhura logjikisht dhe nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, pasi, sipas tij, ka kundërthënie, kontradiksion të hapur dhe të fshehtë.

40.1. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se konkluzionet e nxjerra nga Komisioni lidhur me transfertat në llogari të shtetasit Zh., nuk bien ndesh me njëri-tjetrin dhe as kanë tendencën të rëndojnë pozitën e subjektit, por se ato janë pasojat në të cilat ka arritur Komisioni, pasi ka konstatuar se rrethanat në të cilat janë kryer këto transfertat, nuk janë në përputhje me vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes, duke mos u dhënë një shpjegim bindës lëvizjeve monetare të realizuara me këto transfertat.

40.2. Përkundër sa pretendon subjekti i rivlerësimit, vendimi i Komisionit është logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe argumentet e pjesës arsyetuese janë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke formuar një përmbajtje koherente brenda vendimit, pa u konstatuar kundërthënie, kontradiksion i hapur dhe i fshehtë, pasi vendimi përmban çdo element të formës, pjesën hyrëse, përshkruese-arsyetuese dhe urdhëruese, dhe në përmbajtje të secilës pjesë përbërëse janë renditur rregullisht, me lidhje organike, elementet përkatëse, sipas përcaktimit të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016.

- 41.** Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka evidentuar mospërputhje midis deklarimeve të tij dhe deklarimeve të dhëna nga shtetasi N.M., pasi në dëshminë e tij dhënë Komisionit më datë 01.10.2018, z. N.M. deklaroi se *e ka njohur z. Artor Ylli që në vitet 2008-2009, pasi e ka pasur student të shkollës jopublike “{***}” dhe më pas ka qenë asistent avokat pranë zyrës së tij të avokatisë, për efekt të provimit përfundimtar të avokatisë, meqenëse i duhej vërtetim si asistent avokat, ndërsa nga deklarimi në formularin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka mbaruar studimet në Universitetin e {***}, Fakulteti i Drejtësisë në {***}*. Po sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni arsyetoi se *ai nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor provues lidhjen dhe shkakun se përse ai duhet ta kryente këtë transfertë në favor të z. N.M. apo biznesit të tij familjar, duke mos provuar se ai ka qenë asistent avokat pranë av. N.M., më datë 01.09.2008, pranë zyrës së tij avokatore, pasi nuk paraqiti as dokumente që provonin se z. N.M. kishte qenë avokat dhe as vërtetim nga Dhoma e Avokatisë Tiranë se ai ishte i regjistruar në regjistrin e asistentëve avokatë pranë av. N.M., sipas ligjit për avokatinë*. Në vijim, subjekti i rivlerësimit, pretendon se vendimi i Komisionit shkel parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, pasi arsyetimi i dhënë nuk përmban fakte të vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre. Duke iu referuar praktikës së konsoliduar gjyqësore të GjEDNJ-së, subjekti i rivlerësimit shpreh se *GjEDNJ-ja konsideron se bazuar në parimet e administrimit të duhur të drejtësisë (la bone administration de la justice) dhe barazisë së armëve (egalite des armes), vendimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet t'i theksojnë në mënyrë adekuate*

arsyet në të cilat ato bazohen (shih Tatishvili kundër Ruisisë, nr. 1509/02 - aktgjykimi i GjEDNj i 22 shkurtit 2007, par. 58 - Hiro Balani kundër Spanjes GjEDNj, kërkesa nr. 18064/91 - Aktgjykimi 9 dhjetor 1994, par. 27 - Higgins dhe të tjerët kundër Francës, GjEDNj, kërkesa nr. 54210/00 - Aktgjykimi i 7 qershorit 2001). Në lidhje me këtë, pretendon subjekti i rivlerësimit, relatori i çështjes, komisioneri Roland Ilia shkoi edhe më tej në një mendim mospajtues, sa ai filloi duke konstatuar se në procesverbalin mbi marrjen e deklaramëve të zbardhura më datë 01.10.2018 nuk është pasqyruar saktë dëshmia e dhënë nga z. N.M., lidhur me rrethanat e njohjes me subjektin e rivlerësimit, dhe se nga dëshmia e marrë nga z. N.M. në prezencën e tij, në cilësinë e relatorit të çështjes, dhe të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, nga dëshmitari u evidentua fakti se e ka njohur subjektin e rivlerësimit pasi vëllain e tij e ka pasur student te shkolla jopublike “{***}” dhe se me pas ka qenë asistent avokat pranë zyrës së tij të avokatisë, ndërsa nga dokumentacioni i administruar në dosje provohet se subjekti ka mbaruar studimet dhe është diplomuar me titullin “jurist” në Universitetin e {***}, Fakulteti i Drejtësisë. Në prapësimet e sjella pranë Komisionit, vijon subjekti i rivlerësimit, ai ka shpjeguar se është i pasaktë deklarimi i z. N.M. se e ka njohur gjatë kohës që ka qenë student në institucionin privat të arsimit të lartë {***} University, dhe se është vënë në dijeni mbi shtrembërimin e dëshmisë së z. N.M. në çështjen e tij vetëm pas arsyetimit të vendimit. Sipas tij, mendimi i pakicës vë në dukje pikërisht këtë reflektim të pavërtetë të dëshmisë që ka ndikuar së tepërmi mbi subjektin e rivlerësimit. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, arsyeton gjatë mbi mënyrën se si e ka njohur z. N.M., duke mos treguar që deklaratat e tij dëshmojnë se ai ka qenë profesor i vëllait të tij në një universitet privat, çka është tërësisht e vërtetë, përveç se ka qenë edhe profesor i tij në një universitet publik dhe avokat pranë zyrës ku ai punonte. Në komunikimet e tij me Komisionin, shprehet subjekti i rivlerësimit, i është deklaruar shprehimisht se z. N.M. ka thënë se ka qenë profesor i tij në një universitet privat, çka është dukshëm e pavërtetë, sipas tij dhe çka ai e ka kundërshtuar menjëherë. Lidhur me deklarin e z. N.M. para Komisionit, se e ka njohur subjektin e rivlerësimit gjatë kohës që ka qenë student në institucionin privat të arsimit, Shkolla e Lartë Universitare {***} University, ky fakt është i pasaktë, pasi, vijon subjekti i rivlerësimit, ai nuk ka qenë student në këtë institucion, por se ka kryer studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i {***}, dhe është diplomuar “jurist” në këtë fakultet, në vitin 2008, dhe se z. N.M. e ka njohur gjatë vitit akademik 2007-2008 në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i {***}, ku ishte i angazhuar si pedagog i jashtëm për dhënien e lëndës “E drejta publike”. Në veçanti, pretendon subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka dështuar në detyrën e tij për të lidhur në mënyrë të mjaftueshme rregullat e zbatueshme me faktet e rastit, sikurse kërkohet, me të drejtën për një vendim të arsyetuar për një gjykim të drejtë. Drejtësia procedurale, vijon me pretendimet e tij subjekti i rivlerësimit, kërkon që pretendimet esenciale që palët ngrenë duhet të përgjigjen në mënyrë të duhur nga gjykatat/tribunalet, në pajtueshmëri me kërkesat e të drejtën për gjykim të drejtë, dhe në këtë mënyrë është pamundësuar të kontrollohet saktësia e procesverbalit dhe kjo ka sjellë shkelje të etikës së dy komisionerëve dhe ka cenuar besimin e tij në integritetin e Komisionit. Në vijim, parashtron se ka pasur dallime mes asaj çka ka deklaruar dëshmitari në procesverbalin që është mbajtur nëpërmjet regjistrimit audio dhe asaj që deklaroi Komisioni në këtë vendim, dhe se ky pretendim lidhur me thëniet e dëshmitarit, sërish ka të bëjë me spekulime nga ana e Komisionit dhe është i pambështetur, dhe se pretendimi i tij mbështetet edhe nga relatori i çështjes, Komisioneri Roland Ilia, dhe kjo pasi thënia e dëshmitarit, z. N.M., është marrë në prezencën e komisionerit Roland Ilia, në cilësinë e relatorit të çështjes, dhe të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, fakt që sipas subjektit të rivlerësimit ka ndikuar në paanshmërinë e Komisionit, dhe rrjedhimisht vihet në pyetje parimi i gjykimit të drejtë, të paanshëm, të garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNj-së.

41.1. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se rrethanat e njohjes së subjektit të rivlerësimit janë tregues të motivimit që kanë shtyrë këtë të fundit për të kryer transaksionet bankare, si arsye të brendshme të formësimit të vullnetit, por që nuk ndikojnë në paanshmërinë e Komisionit, sepse nuk janë përcaktuese për cenimin e garantimit të paanësisë³⁵, sipas nenit 27 të ligjit nr. 84/2016. Të gjitha këto pretendime të subjektit të rivlerësimit, si më sipër, nuk arritën të shpjegojnë se si rrethanat në të cilat ai ka njohur z. N.M. kanë rëndësi vendimtare në konstatimin e fakteve të pakontestueshme që subjekti i rivlerësimit ka punuar asistent avokat, që subjekti i rivlerësimit ka kryer transferta bankare në drejtim të Kinës dhe që subjekti i rivlerësimit nuk arriti të rrëzojë përfundimin e Komisionit se këto transferta, disa prej të cilave vite pasi subjekti i rivlerësimit nuk punonte më si asistent i z. N.M., minimalisht përbëjnë mungesë gjykimi të shëndoshë nga ana e subjektit të rivlerësimit.

42. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit parashtroi se Komisioni ka cenuar parimin e barazisë së armëve, parimin e gjykatës së caktuar me ligj gjatë hetimit administrativ, pasi edhe pse gjatë hetimit administrativ u paraqit nga subjekti i rivlerësimit një vërtetim i lëshuar nga z. N.M., sipas të cilit ai ka filluar si asistent pranë zyrës së avokatisë së z. N.M. më datë 01.09.2008, ai nuk u morr parasysh nga Komisioni. Po ashtu, parashtroi subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, Komisioni me shkresën nr. {***} prot., datë 08.10.2018, i është drejtuar DhKASH-së me qëllim konfirmimin e faktit nëse ai ka qenë asistent dhe nëse ka kryer praktikën pranë zyrës së av. N.M., por se me arsyen se ende nuk i ishte kthyer përgjigje, Komisioni ka përfunduar hetimin administrativ, duke mos e administruar këtë shkresë. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, bazuar në standardet e mësipërme dhe në rrethanat e çështjes konkrete, Komisioni ka vepruar tej kompetencave ligjore, duke cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, si një nga elementet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, dhe se gjithashtu është cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi Komisioni nuk ka arsyetuar lidhur me shkaqet që e çuan për të mos administruar shkresën që vetë Komisioni i drejtoi DhKASH-së. Sipas praktikës së GjEDNj-së, referon subjekti i rivlerësimit, funksioni esencial i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar dhe, për më tepër, parashtroi subjekti i rivlerësimit, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për t'u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga organi i apelit, dhe se vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë (shih *mutatis mutandis* *Hrvisar kundër Finlandës*, nr. 49684/99, par. 30, 27 shtator 2001; shih gjithashtu *Tatishvili kundër Rusisë*, kërkesa nr. 1509/22, aktgjykimi i 22 shkurtit 2007, par. 58). E drejta për të marrë një vendim gjyqësor në pajtim me ligjin, sipas subjektit të rivlerësimit, përfshin detyrimin që gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre me bazë të arsyeshme si në nivelin procedural, ashtu edhe në atë material (shih *IKK Classic* - aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, par. 54), dhe duke vijuar pretendon se në analizë të kuadrit ligjor të cituar me lart, *fryma e normës kushtetuese dhe e atyre [normave] të ligjit nr. 84/2016 janë të orientuara drejt një roli aktiv të Komisionit, lidhur me hetimin dhe marrjen e të gjitha të dhënave që çmohen të nevojshme për të bërë një vlerësim të plotë dhe të gjithanshëm të komponentëve të rivlerësimit. Në kuptim të funksioneve dhe detyrave që kanë këto organe, subjekti i rivlerësimit vlerëson se është*

³⁵ Neni 27, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, përcaktojnë se: "1. Anëtarit i institucioneve të rivlerësimit deklarohet dhe shmang çdo situatë konfliktuale të interesit, në respektim të ligjit "Mbi parandalimin e konfliktit të interesit". Çdo vendim i marrë në një situatë konfliktuale të interesit, përveç pasojave ligjore në procesin e vendimmarrjes, përbën shkelje disiplinore, sipas këtij ligji. dhe 2. Në rast se anëtarit i institucioneve të rivlerësimit nuk mund të shqyrtojë një çështje që i është caktuar për shkaqet e përmendura në nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative ose të ligjit "Mbi parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike", ai njofton me shkrim menjëherë trupin gjykues. Përfundimi i komisionerit, gjyqtarit ose Komisionerit Publik nga shqyrtimi i çështjes vendoset nga një tjetër trup gjykues që caktohet me short."

brenda kompetencës së tyre që të investigojnë dhe të marrin çdo të dhënë të nevojshme për hetimin, me qëllim arritjen e një konkluzioni të mbështetur në prova dhe në përputhje me ligjin, dhe se Komisioni nuk mund të qëndrojë pasiv dhe të kryejë një hetim të paplotë, veçanërisht në rastet kur çmohet se momente të caktuara që lidhen me rivlerësimin duhen sqaruar plotësisht, duke përfunduar se Aneksi i Kushtetutës, neni Ç, paragrafi i katërt përcakton kompetencën e organeve të rivlerësimit, Komisionit e Kolegjit, që të kryejnë një sërë veprimesh për të konfirmuar vërtetësinë e saktësinë e deklarimeve të subjekteve në procesin e rivlerësimit, dhe se ky detyrim kushtetues përcakton pikërisht funksionin investigativ të pavarur të organeve, funksion i cilësuar edhe në vendimin nr. 2/2007 të Gjykatës Kushtetuese.

42.1. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson si të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe i gjykatës së caktuar me ligj, me arsyetimin se nuk është konfirmuar nga Komisioni fakti nëse ai ka qenë asistent dhe nëse ka kryer praktikën pranë zyrës së av. N.M. Komisioni, sipas përcaktimit të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, ka arritur në përfundimin se provat e administruara kishin nivelin e provueshmërisë, dhe ishte subjekti i rivlerësimit ai që kishte barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën në këtë drejtim.³⁶ Me këtë procedurë, subjektit të rivlerësimit i është garantuar e drejta e mbrojtjes aktive dhe efektive në këtë proces administrativ të hetimit ndaj tij. Komisioni ka arsyetuar në mënyrë logjike dhe me argumente të bazuara në prova dhe në faktet evidente të administruara në dosje. Komisioni ka verifikuar, hetuar dhe vlerësuar të gjitha deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për këtë kriter të rivlerësimit, i ka komunikuar palës, subjektit, rezultatet përfundimtare të hetimit, i ka kaluar barrën e provës për ato asete që ka çmuar se kërkonin shpjegime shtesë nga subjekti, i ka garantuar të drejtën e dëgjësës publike, si dhe të drejtën e aksesit të njohjes me dosjen, provat përkatëse dhe të drejtën e kundërshtimit të tyre.

43. Në përfundim të vlerësimit të detyrimeve tatimore ndaj DRT Tiranë dhe Njësisë Kashar, Komisioni ka arritur në përfundimet³⁷ se:
- a) subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, pasi nuk ka deklaruar detyrimin tatimor ndaj Njësisë Administrative Kashar, në deklaratën *vetting* të vitit 2017;
 - b) pavarësisht faktit se ai ka paguar detyrimet në momentin kur iu paraqitën rezultatet e hetimit, ai duhej të kishte pasur dijeni dhe ta kishte paguar atë para deklaratës *vetting* të vitit 2017, dhe se deklarimi i detyrimit dhe/ose shlyerja e tij duhet të kishin ndodhur para se të deklaronte;
 - c) pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk kishte dijeni për këtë detyrim në ngarkim të tij nuk qëndron, sepse subjekti i rivlerësimit nuk provoi pamundësinë e mospasjes së dijenisë së tij në lidhje me këtë detyrim;
 - ç) mospagimi i taksave e tatimeve pranohet nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe, sikurse rezulton e provuar, këto detyrime u paguan gjatë procesit të rivlerësimit;
 - d) trupi gjykues i Komisionit çmoi se është e vërtetë që legjislacioni tatimor parashikon se në rast pagese me vonesë aplikohen penalitete, por çmon se këto detyrime u paguan gjatë procesit dhe veprimet apo mosveprimet e tij janë sjellje që tregojnë mungesë *etike* dhe integriteti, elemente që cenojnë figurën e magjistratit.

³⁶ Neni 52, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016 përcaktojnë se: “1. Komisioni dhe Kolegji i Apelit në shqyrtimin e çështjes udhëhiqen nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit; dhe 2. Nëse Komisioni ose Kolegji i Apelit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45, të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën”.

³⁷ Shih faqen 12, paragrafi i fundit, faqen 13, paragrafi i parë i vendimit nr. 73, datë 02.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

44. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se nuk qëndron përfundimi i arritur nga Komisioni për deklarim të pamjaftueshëm për detyrimin tatimor ndaj Njesisë Kashar, pasi në faqen 7 të deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit shprehimisht ka deklaruar: “Detyrim fiskal ende i pashlyer ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, në shumën 242.618 lekë, dhe ndaj Njesisë Administrative Kashar 143.780 lekë”, dhe: “Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, deri në datën e fillimit të rivlerësimit, me shifra dhe me fjalë, 386.398 lekë (treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë)”.

45. Për sa i përket marrjes dijeni për ekzistencën e detyrimeve tatimore pasi, sipas rastit, për deklarimin e detyrimeve tatimore dhe pagesën e tyre apo të sigurimeve shoqërore/shëndetësore, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se ligji tatimor me dispozita urdhëruese përcakton mënyrën dhe afatet për përmbushjen e detyrimeve tatimore të lindura sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9632/2006”), sikurse edhe detyrimin për të deklaruar të dhënat për kontributet në total dhe për çdo individ sipas ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9136/2003”), si dhe detyrimin për të deklaruar për çdo periudhë tatimore sipas ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.

45.1. Neni 14, pika 1 e ligjit nr. 9632/2006 përcaktonte se: “1. Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiskal”.

45.2. Pas ndryshimeve³⁸ me ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013, neni 15, pika 4 përcaktonte se: “Pagesat e kësteve të tatimit kryhen te bankat e nivelit të dytë për llogari të administratës tatimore, brenda datave 20 prill, 20 korrik, 20 tetor dhe 20 dhjetor të çdo viti [...]. Tatimpaguesit me qarkullim nga 0 deri në 2 milionë lekë në vit paguajnë tatimin fiks në masën 25.000 lekë në vit, te drejtoritë rajonale tatimore brenda gjashtëmujorit të parë të çdo viti, te bankat e nivelit të dytë, për llogari të drejtorisë rajonale tatimore”.

45.3. Neni 10, pika 1 e ligjit nr. 9136/2003, përcaktonte se: “1. Personi i detyruar për të paguar kontribute, për çdo periudhë, duhet të deklarojë në organet tatimore të dhënat për kontributet në total dhe për çdo individ. [...]” – dhe neni 11, pika 1, gjerat “b” dhe “ç” përcaktonin se: “b) nga personat fizikë, përjashtuar personat fizikë të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Deklarata në këtë rast do të përfshijë personat e vetëpunësuar, punonjësit e papaguar të familjes si dhe të punësuarit” dhe: “Deklarimet e parashikuara në nenin 10 dhe pagesa e kontributeve bëhen në afatet e mëposhtme: [...] ç) nga personat fizikë të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik. Deklarata në këtë rast do të përfshijë personat e vetëpunësuar, punonjësit e papaguar të familjes, si dhe të punësuarit”.

45.4. Pas ndryshimeve me ligjin nr. 87/2014, datë 17.07.2014, neni 10, pika 1, përcaktonte se: “1. Personi juridik dhe fizik i detyruar për të paguar kontribute, për çdo periudhë, duhet të deklarojë, në formë elektronike, në organin tatimor të dhënat e detyrimeve për kontributet në total dhe për çdo individ”.

³⁸ Të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”.

- 45.5. Neni 37, pika 1 – “Deklaratat për periudhat tatimore” – e ligjit nr. 7928/1995 përcaktonte se: “1. Çdo person i tatuashëm detyrohet: a) të bëjë një deklaratë në bazë të nenit 32 të këtij ligji për çdo periudhë tatimore jo më vonë se 14 ditë pas përfundimit të periudhës tatimore me të cilën ajo lidhet; b) të paguajë TVSh për atë periudhë, në ose para datës së detyrueshme të deklaratës [...]”.
46. Sipas përcaktimeve të nenit 7, germa “ç” e ligjit nr. 33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore” (në vijim “ligjit nr. 33/2017”), pavarësisht periudhës që i përkisnin, ishin objekt i fshirjes/shuarjes, detyrimet tatimore në vijim: [...] ç) *dënimet administrative (gjobat) për mosdeklarim në afat, për deklarata të padorëzuara me kusht që çdo deklaratë e padorëzuar të dorëzohet deri në dt.30.6.2017.*
47. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti rivlerësimi i ka dorëzuar deklaratat përkatësisht³⁹ në datat 10.11.2017 dhe 11.11.2017, pra jashtë afatit të përcaktuar nga ligji nr. 33/2017, dhe për këtë arsye gjobat e vendosura nuk ishin as mund të jenë objekt fshirjeje/shuarjeje, sipas këtij ligji.
48. Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 10.07.2018, të DRT Tiranë, dhe shkresës për detyrimet në kohë reale për Artor Ylli, me NIPT {***}, detyrimi kryesor ishte “zero”, dhe detyrimet tatimore përbëheshin nga “gjobat”, në total 193.061 lekë, përkatësisht:
- gjobë në shumën 125.000 lekë për TVSh-në;
 - gjobë në shumën 10.000 lekë për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin;
 - gjobë në shumën 5.000 lekë për kontributet e sigurimeve shoqërore ose shëndetësore;
 - gjobë në shumën 20.000 lekë për tatimin mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël;
 - gjobë në shumën 29.406 lekë dhe interes në shumën 3.655 lekë për kontribute shoqërore.
49. Subjekti i rivlerësimi pretendon se vendimi i kontestuar lidhur me mospagimin e detyrimeve tatimore nga ana e tij, shkel të drejtat dhe liritë themelore të këtij të fundit, pasi referuar pikës 2 të nenit 18 të Kushtetutës, askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla, si: gjinia, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare e filozofike, gjendja ekonomike, arsimore sociale ose përkatësia prindërore. E drejta e mosdiskriminimit, parashtron subjekti i rivlerësimi, është njohur me instrumentet kryesore ndërkombëtare, siç janë Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Pakti Ndërkombëtar i KB-së për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa e KB-së për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore, Konventa e KB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor dhe Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) nr. 111. Dispozitat për mosdiskriminim që i përmban KEDNj në mënyrë plotësuëse, të përforcuara me hyrjen në fuqi të Protokollit 12 të kësaj konvente, me të cilën garantohet e drejta e pavarur e trajtimit të barabartë. Vendimi, sipas subjektit të rivlerësimi, ka krijuar një gjendje objektive paragjyquese, diskriminuese dhe pabarazie para ligjit të këtij të fundit, pasi Komisioni ka përdorur si argument për shkarkimin e tij disa detyrime tatimore kur ka punuar si avokat para shumë vitesh, për të cilat nuk ka pasur mundësi për t’i paguar në kohë për shkak të pamundësisë së tij ekonomike. Në vijim parashtron se ka qenë avokat i ri në ato vite dhe menjëherë pasi është vënë në dijeni për ekzistencën e detyrimeve tatimore, vetëm 5 ditë para seancës dëgjimore, ka shlyer detyrimin tatimor ndaj Njësisë Administrative Kashar dhe disa ditë pas vendimit të shkarkimit, parashtron se ka marrë kontratë kredie *overdraft* në bankën në të cilën merrte bursën e Shkollës së Magjistraturës, duke përmbushur çdo detyrim ndaj DRT Tiranë. Gjithashtu, parashtron se mospagesa e një pjese të detyrimit tatimor ka lindur gjatë kohës që kishte qenë avokat dhe nuk

³⁹ Bashkëlidhur shkresës së DRT Tiranë me shkresën nr. {***} prot., datë 10.07.2018, dërguar KPK.

lidhej me çështje të besueshmërisë, ndershmërisë dhe integritetit të tij si person. Në vijim, pretendon se ka qenë objekt i diskriminimit nga dy komisionerët, diskriminim i cili ka qenë joproporcional dhe nuk ka përmbushur kurrfarë qëllimi legjitim, dhe se gëzimi i të drejtave të njeriut në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim garantohet nga Kushtetuta. Neni 14 i KEDNj-së, parashtron subjektin e rivlerësimit, garanton barazinë në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, dhe Protokollin 12 ndalon diskriminimin në lidhje me gëzimin e çdo të drejte dhe lirie të parashikuar nga ligji dhe kështu është më i zgjeruar fushëveprimi i tij sesa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNj. Veç sa më sipër, vijon subjektin e rivlerësimit, çka përbën edhe një pjesë të konsiderueshme të vendimit të dhënë për të, Komisioni ka arritur ta diskriminojë bazuar në faktin se nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiare për të paguar detyrimet që autoriteti tatimor kishte vendosur për atë, në një kohë kur nuk ka qenë në dijeni të këtyre detyrimeve. Gjithashtu, subjektin e rivlerësimit parashtron se autoriteti tatimor nuk lejon një çregjistrim kur ka gjoha të papaguara, por se fatkeqësisht në rastin e tij e lejoi një gjë të tillë, duke theksuar po ashtu se nuk është njoftuar asnjëherë zyrtarisht nga autoritetin tatimor për këto detyrime të papaguara, por se në momentin që është njoftuar nga Komisioni, parashtron se ka marrë edhe kredi për t'i paguar detyrimet tatimore. Në përfundim, subjektin e rivlerësimit parashtron se nuk është i pasur, por fakti që ka paguar detyrimet sapo u njoftua, duke ngarkuar me kredi bursën e tij, dëshmon që është një individ i cili e respekton ligjin, duke pretenduar se nuk mund të diskriminohet për shkak të faktit që nuk ka pasur kursime të mjaftueshme, por se kishte rreth 20.000 lekë kursime në llogarinë e pagës, siç tregon vetë vendimi. Gjithashtu, subjektin e rivlerësimit pretendon se kjo nuk e bën joetik dhe as e bën të predispozuar për të qenë lehtësisht i manipulueshëm, dhe nëse do të kishte qenë ky rasti, llogaria e tij e kursimeve do të dukej ndryshe, por se është një student që nuk ka kapital, as pasuri të paluajtshme, e madje as pasuri të luajtshme, dhe që tashmë shqetësohet se si të kuptohet drejt dhe si të bëjë të qartë se qëllimi i reformës nuk mund të ketë qenë ky, që të shkarkojë studentët sepse nuk janë të pasur, duke përfunduar me shprehjen: “të jesh i varfër nuk është joetike”.

49.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni nuk ka arritur në konkluzion në mënyrë diskriminuese ndaj subjektit të rivlerësimit, sikurse ai pretendon, për shkaqe të tilla, si: gjinia, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare e filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore, por se ka çmuar se fakti që detyrimet tatimore u paguan gjatë procesit dhe veprimet dhe mosveprimet e tij ishin sjellje që tregonin mungesë etike, integriteti, që janë elemente që cenojnë figurën e magjistratit. Mospagimi i taksave është një veprim që bie ndesh me etikën, pasi tregon mungesë respekti dhe shkelje të ligjit për tatimet, porë në dritën e dispozitave të neneve 30 e 31 të ligjit nr. 84/2016, nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 3, pikat 1-5 të ligjit nr. 96/2016, nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 96/2016. Për më tepër, subjektin e rivlerësimit nuk ka shtjelluar mbi ç'bazë e ka diskriminuar Komisioni dhe pse konkluzioni i Komisionit lidhur me atë vetë përbën diskriminim lidhur me njërin nga cilësitë e përhershme individuale të mbrojtura nga neni 14 i KEDNj-së, sikurse gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, gjuha, besimi fetar, mendimi politik, origjina etnike apo shoqërore, përkatësia në një pakicë kombëtare, pasuria, lindja apo status tjetër.

50. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se në rastin konkret vlerësimi i *etikës* dhe i *integritetit* të subjektit të rivlerësimit, brenda procedurave të vlerësimit të aftësive profesionale, është kryer bazuar në burimet e vlerësimit, të përcaktuara në nenin 42, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, por pa u përfshirë në vlerësimin e kriterit profesional të dhënat që kanë rezultuar nga vlerësimi i pasurive të subjektit të rivlerësimit. Komisioni, nga ana tjetër, etikën dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit e ka vlerësuar si pasojë e rrethanave që kanë rezultuar nga vlerësimi i pasurive, në drejtim të vlerësimit tërësor të

procedurave⁴⁰, dhe për këtë arsye trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se është i pabazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk mund të spekulonte për sjelljen dhe integritetin e tij si asistent avokat dhe më pas si avokat, duke iu referuar për këtë qëllim të dhënave që kanë rezultuar nga burime të tilla, si: DhKASH dhe GjASHP Tiranë.

50.1. Komisioni, me të drejtë, ka vlerësuar se transfertat bankare në mënyrë të përsëritur, të pajustificuara me burime të ligjshme, tregojnë mungesë të theksuar të përmbushjes së vlerave themelore që duhet të udhëheqin një magjistrat të ardhshëm, sipas nenit 3⁴¹ të ligjit nr. 96/2016.

50.2. Këto sjellje, sipas Komisionit, bien në kundërshtim me standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes, sipas nenit 4 të ligjit nr. 96/2016.⁴²

50.3. Për sa u përket detyrimeve tatimore, trupi gjykues i Komisionit, me të drejtë, arsyeton se është e vërtetë që legjislacioni tatimor parashikon se në rast pagese me vonesë aplikohen penaltete, por çmon se këto detyrime u paguan gjatë procesit të hetimit administrativ – gjatë rivlerësimit – dhe veprimet apo mosveprimet e subjektit të rivlerësimit në këtë rast janë sjellje që tregojnë mungesë etike dhe integriteti, elemente të cilat cenojnë figurën e magjistratit.

50.4. Komisioni, me të drejtë, çmon se për kandidatët për magjistratë që synojnë të jenë pjesë e sistemit të ri të drejtësisë, është shumë e rëndësishme sjellja dhe integriteti i tyre para se të kenë qenë pjesë e sistemit, kjo për faktin se veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, si nga mënyra dhe shkaku, janë cilësi të karakterit të subjektit, të cilat nuk mund të mësohen në asnjë institucion edukimi, por janë cilësi individuale të personit, dhe për të garantuar një sistem gjyqësor të pavarur dhe për të rikthyer besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, kontrolli i vërtetësisë së deklarimeve dhe sjellja e përgjithshme e kandidatëve për magjistratë merr një rëndësi të veçantë për shkak se kandidatët për magjistratë janë themelet e një sistemi të pavarur drejtësie, për të arritur objektivin e Kushtetutës dhe të ligjit.

51. Në përfundim, Komisioni pas konstatimeve mbi faktet dhe analizimit të provave, i vlerësoi veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit si sjellje që tregonin mungesë të etikës dhe integritetit të tij, elemente të cilat cenojnë figurën e magjistratit.

⁴⁰ Shih fq. 14-16 të vendimit nr. 73, datë 02.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

⁴¹ Neni 3 i ligjit nr. 96/2016, përcakton se: “1. Magjistrati ushtron funksionet e tij, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin. 2. Magjistrati ushtron funksionet në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brendshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye. 3. Magjistrati nuk duhet të krijojë kontakte të papërshtatshme dhe nuk duhet të ndikohet nga pushteti ekzekutiv ose nga pushteti legjislativ. Magjistrati duhet të marrë çdo masë për të qenë dhe të duket se është jashtë çdo ndikimi prej tyre. Magjistrati njofton menjëherë Këshillin dhe kryetarin, në rast se evidenton ndërhyrje ose ushtrim të ndikimit të papërshtatshëm ndaj tij. 4. Magjistrati ushtron funksionet gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa para-gjykime. 5. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces. Magjistrati ushtron funksionet me drejtësi, në mënyrë korrekte, në kohë të arsyeshme, të ndërgjegjshme, të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike, me objektivitet, vetëpërmbytje dhe maturi.”

⁴² Neni 4 i ligjit nr. 96/2016, përcakton se: “1. Magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare. 2. Magjistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar: a) dinjitetin dhe standardet e funksionit të tij; b) reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë; c) statusin e funksionit të magjistratit. 3. Në përputhje me parashikimet e këtij neni, Këshillat publikojnë standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes. 4. Secili Këshill emëron magjistratin si këshill-tarin e etikës, sipas parashikimeve të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë””.

52. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi i vlerësoi të drejta konkluzionet e Komisionit, sipas paragrafëve më sipër, 35-49, sjell në vëmendje se sipas përcaktimeve të nenit E, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i aftësisë (profesionale) zhvillohet me ndihmën e nëpunësve që ushtrojnë detyrën e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve ose prokurorëve në kohën kur kryhet rivlerësimi, dhe vlerësimi i aftësisë për gjyqtarët, këshilltarët ligjorë ose ndihmësit ligjorë përfshin *aftësinë për të gjykuar, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimin profesional*, bazuar në standardet e parashikuara në ligj, dhe se vlerësimi i aftësisë (profesionale) për këshilltarët ose ndihmësit ligjorë përfshin testimin pranë Shkollës së Magjistraturës.

52.1. Sipas përcaktimeve të nenit 40 të ligjit nr. 84/2016 dhe të neneve 71 e 75 të ligjit nr. 96/2016, vlerësimi i kriterit të *etikës dhe angazhimit ndaj vlerave gjyqësore*, përveç paanësisë, përfshin edhe etikën në punë dhe integritetin.

52.2. Etika dhe integriteti, sipas përcaktimeve të nenit 71, germa “c” dhe 75, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016, maten bazuar në treguesit e përcaktuar në këtë ligj.

52.3. Sipas përcaktimeve të nenit 75, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, etika në punë e magjistratit, në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion, matet duke u bazuar në treguesit e dalë nga burimet e vlerësimit, të tilla si:

- a) rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre;
- b) mendimi i kryetarëve; dhe
- c) vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit.

52.4. Sipas përcaktimeve të nenit 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, integriteti i magjistratit, në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm, matet duke u bazuar në tregues të tillë, si:

- a) rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre;
- b) mendimi i kryetarëve dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit; dhe/ose
- c) raportet e ILDKPKI-së.

53. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se sipas vlerësimit të Komisionit, mungesa e justifikimit me burime të ligjshme për transfertat e kryera dhe përmbushja e detyrimeve financiare/tatimore që rezultuan gjatë procesit, bëjnë që këto veprime apo mosveprime të cenojnë figurën e magjistratit, dhe se për kandidatët për magjistratë që synojnë të jenë pjesë e sistemit të ri të drejtësisë, është shumë e rëndësishme sjellja dhe integriteti i tyre para se të kenë qenë pjesë e sistemit.

53.1. Duke i vlerësuar në tërësi këto veprime/mosveprime, Komisioni, i ka vlerësuar si “sjellje që tregojnë mungesë të etikës dhe integritetit, të cilët cenojnë figurën e magjistratit”, të cilat “në vlerësimin tërësor të çështjes, faktet dhe rrethanat që Komisioni dispononte, nuk arrinin nivel të besueshëm për subjektin e rivlerësimit, duke cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë⁴³”.

53.2. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se është i bazuar në ligj qëndrimi i Komisionit se kryerja e transfertave bankare në mënyrë të përsëritur, të pajustificuara me burime të ligjshme, tregon mungesë të theksuar të përmbushjes së vlerave themelore që duhet të udhëheqin një magjistrat të ardhshëm, sipas

⁴³ Shih f. 16, par. e fundit të vendimit nr. 73, datë 02.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

neneve 3, pikat 1 dhe 5⁴⁴ dhe 4, pika 1⁴⁵ e ligjit nr. 96/2016. Kryerja e këtyre transfertave bankare nga subjekti i rivlerësimit Artor Ylli është bërë në mënyrë të vazhdueshme.

53.3. Për këto transferta bankare⁴⁶, të kryera në mënyrë të përsëritur, subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të tyre apo të z. N.M., përkundrazi, subjekti i rivlerësimit dhe z. N.M. kanë pohuar para Komisionit se këto transferta kishin për qëllim aktivitetin tregtar, familjar të z. N.M., por pa i shoqëruar këto pohime me dokumentet tatimore apo doganore, sipas urdhërimeve të legjislacionit në fuqi, në kohën e kryerjes së këtyre transfertave.

53.4. Pretendimi i ngritur nga subjekti i rivlerësimit se ky i fundit ka vepruar në mirëbesim, nuk qëndron, sepse veprimtaria tregtare, shitblerja e mallrave apo ofrimi i shërbimeve, është një fushë që legjislacioni tatimor e ka rregulluar me dispozita urdhëruese ligjore, çka nuk i lejon subjektet tregtare të vepronë me bazë mirëbesimi, por i urdhëron ato që aktivitetin ekonomik ta shoqërojnë detyrimisht me dokumente tatimore, në përputhje me përcaktimet ligjore, sepse në bazë të nenit 157, pika 1, fjalia e parë e Kushtetutës, buxheti i shtetit krijohet, ndër të tjera, edhe nga të ardhurat e mbledhura prej taksave, tatimeve.

53.5. Në një kohë që nuk qëndron pretendimi se subjekti i rivlerësimit ka vepruar me mirëbesim në kryerjen e transfertave bankare për qëllime tregtare, por pranohet nga subjekti i rivlerësimit dhe z. N.M. se këto transferta bankare kishin për objekt veprimtarinë tregtare, por pa u shoqëruar me dokumentet përkatëse tatimore, trupi gjykues i Kolegjit⁴⁷ vlerëson⁴⁸ se këto transferta janë sjellje të kryera nga

⁴⁴Neni 3, pikat 1 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016 përcaktojnë se: “1. Magjistrati ushtron funksionet e tij, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin. 5. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces. Magjistrati ushtron funksionet me drejtësi, në mënyrë korrekte, në kohë të arsyeshme, të ndërgjegjshme, të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike, me objektivitet, vetëpërmbytje dhe maturi.”

⁴⁵ Neni 4, pika 1 e ligjit nr. 96/2016 përcakton se: “1. Magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare”.

⁴⁶ Në datën 14.12.2010, në vlerën 16000 USD, me përfitues z. Zh., në datën 13.02.2012, në vlerën 30000 USD, me qëllim shlyerje detyrimi; dhe në datën 02.11.2010, transfertë cash në vlerën 10000 USD, me përfitues z. Zh., me qëllim shlyerje detyrimi.

⁴⁷ Nuk ka rezultuar asnjë akt nga materialet e dosjes që t'i japë subjektit të rivlerësimit tagrat e personit të autorizuar nga z. N.M., sikurse është shprehur në përgjigjen e pyetësorit. Gjithashtu, nuk kishte asnjë kufizim sasiar të përcaktuar nga rregullorja e Bankës së Shqipërisë, për sa u përket vlerave të transfertave dhe, për këtë arsye, në rast se transfertat do të ishin për z. N.M., ky i fundit nuk kishte pengesa ligjore për t'i bërë në mënyrë të drejtpërdrejtë këto pagesa.

⁴⁸ Gjatë hetimeve paraprake në përgjigje të pyetësorit të Komisionit subjekti i rivlerësimit është shprehur se: “Përfitoj nga rasti t'ju konfirmoj se mbi bazë transfertën jashtë vendit në llogari, unë kam vepruar për llogari të shtetasit N.M. dhe në këtë cilësi për të vepruar si përfaqësues i autorizuar i tij, në lidhje me këtë veprim, kam vepruar për shkak se kam kryer stazhin e asistent avokatit pranë këtij të fundit, profesor N.M. është avokat me të drejtë ushtrimi të profesionit në Republikën e Shqipërisë dhe zv.rektor i Kolegjit Universitar {***}, me gradën shkencore Doktor në drejtësi. Unë kam vepruar në këtë cilësi në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij në rregulloren “Për veprimtarinë valutore”, miratuar me vendimin nr. 70, datë 30.09.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Sipas përmbajtjes së shkresës private, dt.6.7.2018, të nënshkruar nga z. N.M., e quajtur deklaratë, ky i fundit shprehet se: “Unë N.M., ID {***}, adresa rr. “{***}”, {***}, Tiranë, banesë private, deklaroj me përgjegjësi ligjor se më dt 14 dhjetor 2010 dhe më dt. 13.2.2012, z. Artor Ylli ka transferuar për llogarinë time, në {***} (shumën 16.050 USD dhe 30.080 USD) në drejtim të Republikës së Kinës për Zh. Sipas rregullave bankare deri në fund të vitit 2014, çdo shtetas shqiptar lejohej si individ të transferonte shumën deri në 3,5 milionë lekë (ose ekuivalente me këtë shumë) brenda një viti kalendarik”.

subjekti i rivlerësimit jashtë ushtrimit të funksionit dhe gjatë procesit të rivlerësimit, që janë në kundërshtim me:

- a) sjelljen e subjektit të rivlerësimit, sjellje e cila mbahet parasysht nga trupi gjykues i Kolegjit sipas përcaktimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016;
- b) vlerat themelore, pasi nuk garantojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas përcaktimit të nenit 3, pika 5 e ligjit nr. 96/2016; dhe
- c) faktin se këto sjellje cenojnë standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes, pasi nuk janë në përputhje me masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit edhe kur nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare dhe për të mbrojtur dhe forcuar reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas përcaktimit të nenit 4, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 96/2016.

53.6. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se është i bazuar në ligj qëndrimi i Komisionit se pagimi i detyrimeve tatimore nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit dhe veprimet dhe mosveprimet janë sjellje në kundërshtim me standardet e etikës, sipas përcaktimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, dhe nenit 4, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 96/2016.

53.7. Në një kohë që pretendon se nuk është njoftuar për detyrimet tatimore, rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*⁴⁹ i ka deklaruar llojin, shumën dhe organin publik ndaj të cilit është debitor për detyrime tatimore, çka bie në kundërshtim me pretendimin e mosnjoftimit të detyrimit, dhe për më tepër qëndrimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimeve paraprake tregojnë tendencë të subjektit të rivlerësimit për t'iu shmangur detyrimeve tatimore⁵⁰, në kushtet kur ai rezulton i çregjistruar dhe këto veprime dhe mosveprime janë sjellje të kryera nga subjekti i rivlerësimit jashtë ushtrimit të funksionit dhe gjatë procesit të rivlerësimit, që janë në kundërshtim me sjelljen e subjektit të rivlerësimit, sipas

⁴⁹ Në f. 7 të deklaratës *vetting*, shprehimisht subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Detyrim fiskal ende i pashlyer ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në shumën 242.618 lekë dhe ndaj Njesisë Administrative Kashar 143.780 lekë”.

⁵⁰ Gjatë hetimeve paraprake në përgjigjeje të pyetësorit të datës 06.07.2018 të Komisionit, subjekti i rivlerësimit është shprehur se: “1. Detyrimet tatimore të papaguara, i përkisnin periudhave tatimore dhjetor 2014 e më parë dhe që rezultonin të regjistruara në llogarinë e subjektit, deri në fund të vitit 2017 dhe kanë lindur gjatë kohës që kam ushtruar profesionin e avokatit. Lidhur me këto detyrime tatimore, në muajin nëntor 2017 kam bërë disa pagesa kundrejt detyrimeve tatimore në Alpha Bank ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. 1.2. Administrata tatimore pas përfundimit të fshirjes/shuarjes sipas kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 33/2017, më njoftojë në e-filing system me anë të një mesazhi, i cili në përmbajtje të tij më informoi se: “Në zbatim të ligjit nr. 33 datë 20.03.2017 “Për pagesën dhe shuarjen e pjeshme të detyrimeve tatimore, doganore, si dhe procedura e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit, pas fshirjes së detyrimeve tatimore”, ju informojmë se efekti i i tij është përfshirë në situatën tuaj financiare në sistemin informatik. 2. Kam aplikuar për t'u çregjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) pranë sporteve të përcaktuara sipas ligjit nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, kërkesë e cila është pranuar. Nga datë 29.01.2018 rezultoi i çregjistruar në QKB dhe nuk kam detyrime tatimore të papaguara. 3. Në nenin 45 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, parashikohet se: “5. Qendra Kombëtare e Regjistrimit ose gjykata nuk mund të kryejë çregjistrimin, në qoftë se brenda afatit 3-ditor, të përmendur në pikën 4 të këtij neni administrata tatimore e kundërshton me shkrim çregjistrimin. **Kundërshtimi i çregjistrimit të tatimpaguesit nga administrata tatimore tregon shumën e detyrimeve tatimore të papaguara tatimpaguesit dhe, në rastin e personit juridik, faktin se ai nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit deri në momentin e likuidimit, ose nuk ka dorëzuar deklaratat tatimore**”. Nuk është i besueshëm subjekti i rivlerësimit, kur i referohet nenit 45, pika 5 e ligjit nr. 9920/2008, me pretendimin e mospasjes së detyrimeve tatimore të papaguara, pasi vetëm disa paragrafë më poshtë neni 45, pika 9 e ligjit nr. 9920/2008, sipas ndryshimeve me ligjin nr. 112/2016, përcaktonte se: “9. Çregjistrimi tatimor nuk eliminon detyrimet ekzistuese tatimore dhe nuk parandalon administratën tatimore të vlerësojë ose të mbledhë detyrimet tatimore”. Nuk është i besueshëm subjekti i rivlerësimit, kur pretendon për zbatimin e ligjit nr. 33/2017, pasi subjekti i rivlerësimit i ka dorëzuar deklaratat në datat 10.11.2017 dhe datë 11.11.2017, d.m.th. jashtë afatit të përcaktuar nga ligji nr. 33/2017, dhe për këtë arsye gjatë procesit të rivlerësimit nuk mund të ishij objekt fshirje/shuarje sipas këtij ligji.

përcaktimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, nenit 3, pika 5 e ligjit nr. 96/2016 dhe nenit 4, pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 96/2016.

54. Vendimi nr. 73, datë 02.11.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket këtij subjektit të rivlerësimit Artor Ylli, është i drejtë për sa i përket pasojës, pra shkarkimit të tij si ndihmës ligjor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe njëkohësisht është i drejtë për faktet e marra në shqyrtim, në analizë, nga Komisioni. Ndërsa për sa i përket kualifikimit ligjor të fakteve objekt hetimi, shqyrtimi dhe vlerësimi, në atribuim të këtij subjekti rivlerësimi, në këtë proces të rivlerësimit kalimtar të tij sipas ligjit nr. 84 2016 dhe nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, trupi gjykues i Kolegji çmon se ky subjekt rivlerësimi ndodhet para situatës së administrimit, përdorimit, posedimit dhe disponimit të një pasurie në emër të tij, me shuma financiare mbi 56.000 USD, të administruara nëpërmjet procedurave haptazi të kundërligjshme, të parashikuara nga legjislacioni fiskal shqiptar, ligji për doganat, ligji për tatimet, gjë që e çon subjektin e rivlerësimit në situatën e mosmarrjes së masave të arsyeshme prej tij për të ruajtur dinjitetin e funksionit, me veprimtarinë e tij të ushtruar jashtë funksionit të tij zyrtar. Kjo sjellje e tij procedurale dhe ligjore e bën të cenueshëm besimin e publikut tek ai, si pjesë e sistemit të drejtësisë. Kjo sjellje rezulton e cenueshme sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84 2016, duke iu referuar nenit 3, pikat 1 dhe 5, si dhe nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 96/2016 për referencë fakti, shkaku dhe pasoje, si dhe neneve 40, 41/4, 43/1 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit në lidhje me posedimin dhe disponimin e shumave sipas transfertave bankare, në obligim të neneve 43, pika 3 dhe 48 të ligjit nr. 84/2016, nuk ka garantuar pajisjen e institucionit të rivlerësimit me dokumentet e nevojshme doganore dhe tatimore, si edhe me dokumentet e përfaqësimit apo me kontratë/marrëveshje me personat e tretë të përfshirë në transaksione bankare, sikurse ai pretendon. Pra, përfundimisht, vendimi duhet të mbetet në fuqi me cilësimin juridik të fakteve të mësipërme dhe të veprimeve të tij, sipas përcaktimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84 2016, duke qenë se ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në mënyrë të përsëritur, vazhduese dhe duke bërë që ai të ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit. Ai me sjelljen e tij gjatë procesit të rivlerësimit ndodhet edhe në rrethanat e nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, çka lidhet me mungesën e gatishmërisë dhe sjelljes së tij gjatë procesit të rivlerësimit, duke mos përmbushur detyrimet e tij ligjore në këtë proces të lidhur me nenin 43/3 të ligjit nr. 84/2016. Këto rrethana e çojnë subjektin në përcaktimet edhe të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Në vlerësimin e sjelljes së subjektit të rivlerësimit Artor Ylli, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje edhe qëndrimin e tij, pasi u njoh me vendimin e Komisionit për shkarkimin e tij. Konkretisht, etiketimi mbi baza personale i anëtarëve të trupit gjykues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, publikisht⁵¹, gjatë procesit të rivlerësimit, thjesht për shkak të detyrës së këtyre të fundit, përbën sjellje tejet joetike.
55. Në përfundim të gjykimit të çështjes në dhomë këshillimi, trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi vendimin nr. 73, datë 02.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Artor Ylli, arriti në përfundimin se vendimi është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi, sipas përcaktimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi në vlerësimin tërësor të procedurave në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

⁵¹ <https://www.reporter.al/kandidati-per-gjyqtar-akuzon-kpk-ne-per-standard-te-dyfishte-pas-shkarkimit/>.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me shumicë votash, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 73, datë 02.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Artor Ylli.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
U shpall sot, në Tiranë, më datë 20.11.2019.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi - kundër

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATOR

Luan DACI

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi - kundër

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtar Sokol Çomo, nuk jam dakord me vendimin nr. 31, datë 20.11.2019, të marrë nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) për shqyrtimin e vendimit nr. 73, datë 02.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) që i përket subjektit të rivlerësimit Artor Ylli. Nëpërmjet këtij vendimi, shumica e trupit gjykues vendosi të lërë në fuqi vendimin e sipërcituar të Komisionit, me të cilin ky i fundit ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artor Ylli, me funksion ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
Arsyet e qëndrimit tim në pakicë parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.
2. Komisioni, vendimin e tij (të marrë me shumicë votash), e ka bazuar në parashikimet e nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), ndërkohë që shumica e trupit gjykues të Kolegjit arriti në përfundimin se vendimi i Komisionit është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi, bazuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Duke mos e bazuar vendimin e saj në parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shumica e trupit gjykues të Kolegjit ka pranuar se subjekti i rivlerësimit Artor Ylli nuk ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë kuptim, subjekti nuk u gjet as në kushtet e një deklarimi të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, as në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e tij, as në kushtet e fshehjes së pasurisë, deklarimit të rremë apo gjendjes në situatën e konfliktit të interesit.
3. Në kontradiktë me sa më sipër, në paragrafin 54 të vendimit shumica ka arritur në këtë konkluzion: *[...] trupi gjykues i Kolegjit çmon se ky subjekt rivlerësimi ndodhet para situatës së administrimit, përdorimit, posedimit dhe disponimit të një pasurie në emër të tij, me shuma financiare mbi 56.000 USD, të administruara nëpërmjet procedurave haptazi të kundërligjshme, të parashikuara nga legjislacioni fiskal shqiptar, ligji për doganat, ligji për tatimet, gjë që e çon subjektin e rivlerësimit në situatën e mosmarrjes së masave të arsyeshme prej tij për të ruajtur dinjitetin e funksionit, me veprimtarinë e tij të ushtruar jashtë funksionit të tij zyrtar. Kjo sjellje e tij procedurale dhe ligjore e bën të cenueshëm besimin e publikut tek ai, si pjesë e sistemit të drejtësisë. Kjo sjellje rezulton e cenueshme sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke iu referuar nenit 3, pikat 1 dhe 5, si dhe nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 96/2016 për referencë fakti, shkaku dhe pasoje, si dhe neneve 40, 41/4, 43/1 të ligjit nr. 84/2016 [...].*
4. Referuar sa më sipër, shumica pretendon se subjekti, në një moment të caktuar kohor, kur ai nuk ushtronte asnjë funksion publik, ka administruar, përdorur, poseduar dhe disponuar një pasuri në emrin e tij në vlerën prej 56.000 USD, nëpërmjet procedurave haptazi të kundërligjshme, ndërkohë që shumica nuk ka arritur të identifikojë asnjë situatë faktike që do të mund ta kualifikonte subjektin e rivlerësimit në kushtet e nenit 61, pika 3 dhe të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe as ka treguar se cilat parashikime konkrete të legjislacionit fiskal, doganor dhe tatimor ka shkelur

subjekti i rivlerësimit në kryerjen e transfertave bankare. Në këto kushte, vlerësoj se konkluzionet e mësipërme të shumicës mbeten në nivel paragjykimi.

5. Nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën e trupit gjykues sa u takon konkluzioneve të arritura nga Komisioni, lidhur me ekzistencën e detyrimeve të pashlyera tatimore dhe, në vijim, edhe sa i takon vlerësimit të faktit mbi pagesën e tyre nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit.
6. Rrethanat e faktit lidhur me ekzistencën e detyrimeve tatimore në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, në rastin konkret, nuk cenojnë parashikimet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, për sa kohë referuar natyrës së detyrimit të pashlyer, konstatohet që ky detyrim nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me të ardhurat e krijuara nga subjekti i rivlerësimit, të ardhura të cilat të jenë përdorur qoftë për krijim pasurie apo mbulim shpenzimesh prej tij. Borxhi i krijuar ndaj administratës tatimore, në formën e gjobës (pasi detyrimi kryesor ishte zero), i njohur dhe i dokumentuar në sistemin elektronik të tatimeve, i pranuar nga subjekti i rivlerësimit dhe rrjedhë e deklarimeve tatimore të këtij të fundit pranë organeve kompetente, në kuadër të aktivitetit të tij privat të ushtruar në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi, nuk mund të shërbejë si shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, bazuar në parashikimet e nenit 61, qoftë sa i përket rregullimit të pikës 3 lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, qoftë në drejtim të parashikimeve të pikës 5 të këtij neni, në kuptim të rrethanave që ndikojnë në vlerësimin tërësor, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke e vlerësuar atë si indikator të matjes së etikës dhe integritetit.
7. Për sa i përket zbatimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, vlerësoj se konkluzionet e Komisionit, të konfirmuara nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit, lidhur me pretendimin për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të subjektit të rivlerësimit, në kohën kur ky i fundit nuk ushtronte asnjë funksion publik në sistemin e drejtësisë, nuk mund të merren në analizë në këndvështrim të parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, pasi përbëjnë tejkallim të konceptit të “besimit të publikut te sistemi i drejtësisë”, i cili merr kuptim vetëm në kuadër të personave që ushtrojnë funksione publike. Për rrjedhë, në çështjen konkrete, institucionet e rivlerësimit kanë tejkalluar kompetencat e parashikuara nga kuadri ligjor për rivlerësimin kalimtar të funksionarëve të sistemit të drejtësisë.
8. Për sa më sipër kam votuar për ndryshimin e vendimit të Komisionit nr. 73, datë 02.11.2018, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Artor Ylli.

GJYQTAR

SOKOL ÇOMO

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit, në çështjen që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Artor Ylli kundër vendimit nr. 73, datë 02.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), nëpërmjet të cilit është vendosur lënia në fuqi e vendimit të mësipërm të Komisionit dhe është konfirmuar shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit Artor Ylli, ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Në mënyrë të përmbledhur, Komisioni ka mbështetur vendimin e tij të shkarkimit për subjektin e rivlerësimit Artor Ylli, bazuar në konkluzione të lidhura me kriterin e kontrollit të pasurisë, duke konkluduar për deklaram të pamjaftueshëm për këtë kriter, konkluzione të cilat gjithashtu janë konsideruar domethënëse edhe lidhur me cenimin e besimit të publikut, dhe konkretisht:
 - i) subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm se shumata që ai ka transferuar në vitet 2010-2012 për llogari të shtetasit kinez Zh., kanë burim të ligjshëm, si dhe nëse ato janë detyrime të paguara këtij shtetasi si rrjedhojë e aktivitetit në tregtinë e mallrave nga vetë subjekti apo familjarët e z. N.M., si dhe nuk provoi me dokumentacion shkakun përse ai duhet të kryente këto transferta;
 - ii) subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm pasi nuk ka deklaruar detyrimet tatimore ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në shumën 242.518 lekë (gjoba dhe detyrim) dhe detyrimet ndaj Njesisë Administrative Kashar në shumën prej 144 lekësh;
 - iii) veprimet e subjektit për transfertat bankare të sipërcituara, të pajustificuara me burime të ligjshme, si dhe veprimet e mosveprimet e tij për shlyerjen e detyrimeve tatimore, tregojnë një mungesë të theksuar të përmbushjes së vlerave themelore që duhet të udhëheqin një magjistrat të ardhshëm, sipas nenit 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”).Bazuar në këto konkluzione, Komisioni ka konkluduar që subjekti i rivlerësimit Artor Ylli nuk arrin nivel të besueshëm lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë për deklaram të pamjaftueshëm të tij sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat e administruara në procesin e rivlerësimit, ai nuk arrin nivel të besueshëm, duke cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
3. Sa u përket fakteve të rezultuara gjatë hetimit administrativ në Komision dhe të analizuara edhe nga shumica në vendim, ato nuk do të citohen në mënyrë të detajuar, përveçse kur do të nevojiten gjatë arsyetimit të këtij mendimi pakice.
Gjithashtu, çështjet të cilat nuk janë vlerësuar, arsyetuar dhe konkluduar në mënyrë të posaçme në këtë mendim pakice, i konsideroj të bazuara në ligj dhe prova, ashtu si dhe shumica ka mbajtur qëndrim në vendimin e saj.
4. Në vlerësimin tim, një pjesë e shkaqeve të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit Artor Ylli në ankim, të cilat lidhen me themelin dhe zgjidhjen e çështjes, qëndrojnë dhe e bëjnë të cenueshëm vendimin e Komisionit për shkarkimin e tij, pasi në thelb arsyet mbi të cilat ka vendosur Komisioni dhe të cilat janë konfirmuar në një pjesë të tyre edhe nga qëndrimi i mbajtur nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit, nuk janë shkaqe dhe shkelje të konsideruara nga ligji, të cilat mund të passjellin vendosjen e masës disiplinore të “shkarkimit nga detyra” për subjektin e rivlerësimit.

5. Në vijim po paraqes analizën dhe vlerësimin tim lidhur me çështjet për të cilat kam pasur një qëndrim të kundërt nga shumica në vendim.

I. Transfertat bankare të kryera nga subjekti i rivlerësimit në vitet 2010-2012, nëpërmjet Bankës ICB

6. Kam të njëjtin qëndrim me shumicën në vendim sa i përket interpretimit në përgjithësi të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe konkretisht lidhur me shtrirjen e kontrollit në të shkuarën për subjektin e rivlerësimit, por në vijim të këtij arsytimi do të parashtroj veçoritë të cilat duhet të mbaheshin në konsideratë lidhur me kontrollin në të shkuarën të aftësive profesionale dhe efektet e këtij kontrolli në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit për respektimin e etikës gjatë ushtrimit të detyrës dhe efektin që ajo passjell në cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.
7. Subjekti i rivlerësimit Artor Ylli, për të tria kriteret objekt vlerësimi: pasuror, të figurës dhe profesional, ka plotësuar deklaratat ashtu siç parashikohet në dispozitat e Aneksit të Kushtetutës. Deklarata e plotësuar për efekt të procesit të rivlerësimit për secilin prej kriterëve shërben si pikënisje e këtij procesi dhe deklaratimet e subjektit ballafaqohen me të dhënat e mbledhura nga organet e rivlerësimit, sipas përcaktimeve të neneve 45-52 të ligjit nr. 84/2016. Sa i përket deklaratës së rivlerësimit të pasurisë, kontrolli dhe krahasimi i deklarimeve të mëparshme me deklaratën e pasurisë, gjatë vlerësimit të pasurisë, u shërben organeve të rivlerësimit për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi mjaftueshmërinë e deklarimeve të tij, ligjshmërinë e të ardhurave të tij në vite, burimet e krijimit të pasurisë, si dhe transaksionet e kryera në vite me këtë pasuri. Subjekti i rivlerësimit Artor Ylli, në kuadër të procesit të rivlerësimit, me deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, ka deklaruar pasuritë e paluajtshme apo të luajtshme të tij, të cilat ishin në pronësi apo në përdorim të tij në momentin e deklaramit, të ardhurat që ai ka realizuar në vite, si dhe i ka bashkëlidhur kësaj deklarate edhe një printim të lëvizjeve që ai ka kryer në llogarinë bankare të tij në Bankën Ndërkombëtare Tregtare⁵² (në vijim “Banka ICB”), në të cilën janë të pasqyruara edhe transfertat e kryera në vitet 2010-2012, duke treguar në këtë mënyrë që nuk ka pasur asnjë qëllim të fshehtë transfertat e kryera prej tij nëpërmjet Bankës ICB te shtetasi kinez, z. Zh. Bazuar në sa më sipër, Komisioni ka kryer një proces kontrolli në të shkuarën lidhur me pasurinë e subjektit të rivlerësimit, nga i cili ka rezultuar se ai nuk ka pasuri të paluajtshme të deklaruara apo të cilat janë identifikuar në emër të tij, si dhe sa i përket pasurisë në formën e likuiditeteve disponon vetëm një shumë prej 20000 lekësh gjendje në llogarinë e pagës së tij në momentin e deklaramit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Shuma e parave, e cila ka qenë objekt i transaksioneve bankare të kryera prej tij, rezulton e provuar se nuk është pasuri në formën e likuiditeteve, e krijuar me të ardhura të subjektit të rivlerësimit apo e njohur si detyrim që ai ka pasur ndaj shtetasit kinez, z. Zh., si gjatë viteve 2010-2012 kur janë kryer këto transaksione, ashtu edhe në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit. Gjithashtu, këto shuma dhe transaksione, siç rezulton e provuar nga aktet e administruara në proces, nuk kanë shërbyer si

⁵² *Sot Union Bank.*

burim për krijimin e ndonjë pasurie të paluajtshme apo të luajtshme të tij në vite, nga momenti i kryerjes së transaksionit dhe deri në datën 29.01.2017, kur ka bërë dorëzimin e deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit.

8. Shumica, në vendim, nuk ka konkluduar sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për deklaram të pamjaftueshëm lidhur me justifikimin e burimeve të ligjshme të tij për shumat e transferuara nëpërmjet Bankës ICB, duke vlerësuar që këto shuma nuk kanë qenë pasuri e krijuar me të ardhura të vetë subjektit të rivlerësimit. Bazuar në këtë qëndrim të arsyetuar nga shumica në vendim, konkluzioni i shprehur në paragrafin 53.2, sipas të cilit: “Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se është i bazuar në ligj qëndrimi i Komisionit se kryerja e transfertave bankare në mënyrë të përsëritur, të pajustificuara me burime të ligjshme [...]”, si dhe ai i shprehur në paragrafin 53.3 “Për këto transfertat bankare⁵³, të kryera në mënyrë të përsëritur, subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të tyre apo të z. N.M., përkundrazi, subjekti i rivlerësimit dhe z. N.M. kanë pohuar para Komisionit se këto transfertat kishin për qëllim aktivitetin tregtar, familjar të z. N.M.[...], vlerësoj se i referohet justifikimit të ligjshmërisë së burimit të këtyre likuiditeteve që janë përdorur për të kryer transfertat bankare, për llogari të aktivitetit tregtar të familjes së z. N.M. Për më tepër, shumica edhe pse vlerëson që nuk justifikohen me burime të ligjshme këto shuma të transferuara të z. N.M., përsëri nuk konkludon sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për deklaram të pamjaftueshëm lidhur me justifikimin e burimeve të ligjshme nga subjekti i rivlerësimit.
9. Në ndryshim nga shumica, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk mbart detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimeve për shumat e transferuara nëpërmjet Bankës ICB, për llogari të aktivitetit tregtar që i përkiste familjes së z. N.M., bazuar në përcaktimet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 94/2016. Ligji nr. 84/2016, në nenin 3, “Përkufizime”, pika 14 parashikon: *“Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi. Lidhja e interesit që rrjedh nga një interes pasuror është trajtuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet se cilat marrëdhënie do të përfshihen në sferën e interesit pasuror. Sipas kësaj dispozite: Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Në kuptim të këtij parashikimi, subjekti i rivlerësimit duhet të ketë një marrëdhënie dhurimi, huamarrjeje ose huadhënieje me një person fizik ose juridik dhe ky i fundit duhet ta ketë konfirmuar atë. Në interpretim të këtyre dispozitave kushtetuese dhe ligjore, provueshmëria e ligjshmërisë së burimeve të pasurisë së dhuruar apo dhënë hua nga/apo te personat e tjerë të lidhur është një proces në të cilin, vetë subjekti i rivlerësimit duhet të provojë këtë ligjshmëri burimi, ndërkohë që edhe vetë personat e tjerë të lidhur kanë detyrimin të provojnë ligjshmërinë e burimeve të tyre, nëse konfirmojnë marrëdhënien*

⁵³ Në datën 14.12.2010, në vlerën 16000 USD, me përfitues z. Zh., në datën 13.02.2012, në vlerën 30000 USD, me qëllim shlyerje detyrimi; dhe në datën 02.11.2010, transfertë cash në vlerën 10000 USD, me përfitues z. Zh., me qëllim shlyerje detyrimi.

sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Bazuar në situatën faktike të provuar gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, në zbatim të kuadrit ligjor të sipërcituar, por edhe jurisprudencës së Kolegjit⁵⁴, z. N.M. nuk ka konfirmuar një marrëdhënie dhurimi, huamarrjeje ose huadhënieje me subjektin e rivlerësimit Artor Ylli, ndaj për efekt të procesit të rivlerësimit subjekti nuk detyrohet të provojë burimin e ligjshëm të pasurisë për shumat e transferuara nëpërmjet Bankës ICB, për vitet 2010-2012.

10. Lidhur me motivin për ndërmarrjen e kryerjes së transfertave nga subjekti i rivlerësimit Artor Ylli nëpërmjet Bankës ICB, si dhe nëse subjekti me veprimet apo mosveprimet e tij kishte kryer apo jo shkelje të ligjit, vlerësoj si më poshtë,

10.1 Pavarësisht se vlerësoj që bazuar në interpretimin e bërë në paragrafin 9 të këtij mendimi, subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i detyruar që të provojë burimin e ligjshëm të shumave të transferuara, pasi nuk është konfirmuar asnjë marrëdhënie në një nga format e parashikuara në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ndërmjet subjektit të rivlerësimit Artor Ylli dhe z. N.M., në vijim do të arsyetoj nëse kishte një motiv lidhur me transfertat bankare të kryera nga subjekti, si dhe nëse ai me veprimet apo mosveprimet e tij kishte kryer shkelje të ligjit.

Ndërkohë, nga aktet e administruara gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, konstatoj se subjekti i rivlerësimit është treguar bashkëpunues dhe është përpjekur të provojë dhe argumentojë se cili ka qenë motivi i veprimeve për kryerjen e transfertave prej tij, kujt i përkisnin ato shuma, si dhe nëse veprimet apo mosveprimet e tij kanë qenë në shkelje të ligjit.

Lidhur me motivin e veprimeve të subjektit të rivlerësimit për kryerjen e transfertave, bashkohem me vlerësimin e shumicës në paragrafin 28 të vendimit, sipas të cilit: “[...] rezultojnë rrethanat e njohjes në drejtim të motivimit për kryerjen e transaksioneve për shkak të praktikës si asistent avokat, që më pas kanë evoluar në marrëdhënie shoqërore”. Pra, edhe shumica në vendim, nuk ka dyshime që ndërmarrja e këtyre veprimeve nga subjekti i rivlerësimit ka qenë e motivuar në kuadër të një marrëdhënieje mirëbesimi reciprok, e krijuar për shkak të praktikës së kryer prej subjektit si asistent avokat pranë zyrës ligjore të z. N.M. dhe e zhvilluar më tej si një marrëdhënie shoqërore.

10.2 Sa i përket ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit për transfertat nëpërmjet Bankës ICB, gjatë shpjegimeve në procesin e hetimit administrativ dhe seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision, si edhe në argumentet e parashtruara në ankim, ai ka pranuar që këto transferime bankare janë kryer për llogari të aktivitetit tregtar të familjes së z. N.M. Ky i fundit, në dëshminë e tij, ka mbajtur të njëjtin qëndrim, duke sjellë prova të cilat janë administruar gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, që tregonin se në vazhdimësi ai dhe familjarët e tij kishin kryer aktivitet tregtar me individë ose subjekte tregtare në Republikën Popullore të Kinës. Në arsyetimin e shumicës në paragrafin 29.1 dhe në vijim të vendimit, kundërshtohet vetëm referimi i gabuar që ka bërë z. N.M. në dëshmitë e tij, lidhur me rregullin e zbatueshëm për kufijtë e lejuar për transferimin e kapitalit nëpërmjet bankave, ndërkohë që shumica pranon se sipas rregullores në fuqi⁵⁵ të Bankës së Shqipërisë në vitet 2010-2012, kur janë kryer transfertat nga subjekti i rivlerësimit apo dhe nga vetë z. N.M. dhe familjarët e tij, nuk kishte kufizime për vlerën e lejuar për transfertë.

⁵⁴ Vendimet e Kolegjit nr. 11/2018 (JR), datë 22.11.2018 dhe nr. 5/2019 (JR), datë 18.02.2019.

⁵⁵ Pika 1 e vendimit të Bankës së Shqipërisë nr. 70, datë 30.09.2009, “Për veprimtarinë valutore”, përcakton se: “1. Transferimi i kapitalit nga jashtë-brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nga rezidentët dhe jorezidentët kryhet lirisht dhe pa kufizime [...]”.

Bazuar në pikën 1 të vendimit të Bankës së Shqipërisë nr. 70, datë 30.09.2009, “Për veprimtarinë valutore”, të cituar nga shumica në vendim, sipas të cilit transferimi i kapitalit kryhet lirisht dhe pa kufizime, z. N.M. dhe familjarët e tij apo dhe subjekti i rivlerësimit, pavarësisht shumave/kapitalit të transferuar për llogari të aktivitetit tregtar të familjes së z. M., vlerësoj se kanë qenë në përputhje me rregullin e zbatueshëm në kohën e kryerjes së tyre. Në pikën 3 të po këtij vendimi të Bankës së Shqipërisë, është parashikuar detyrimi që kanë subjektet e licencuara për transferim kapitali⁵⁶ nga brenda jashtë vendit, përfshirë këtu edhe bankat, që të bëjnë të gjitha verifikimet e mundshme për veprime të kryera për llogari të klientëve të tyre pas plotësimit të një dokumentacioni të mirëpërcaktuar, si dhe dokumenteve të tjera shtesë që ato mund t’i çmojnë si të arsyeshme, me qëllim garantimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga klientët e tyre. Për më tepër, siç rezulton nga aktet e administruara në procesin e rivlerësimit në Komision, të referuara edhe në vendimin e shumicës, Banka ICB gjatë kryerjes së këtyre transfertave bankare nga subjekti i rivlerësimit, i ka njohur dhe shënuar ato në përshkrimin e veprimit si “borxh” apo “shlyerje detyrimi”, duke mos i lënë asnjë dyshim subjektit për parregullsi në veprimet e tij, por edhe duke pranuar që këto transferime shumash janë bërë për llogari të aktivitetit tregtar të familjes së z. N.M.⁵⁷. Gjithashtu, referimi në vendimin e shumicës të rregulli i parashikuar në nenin 4, pika 27 e vendimit të Bankës së Shqipërisë nr. 70, datë 30.09.2009, lidhur me regjistrimin e veprimit të transferimit “[...] në llogarinë kapitale dhe/ose në llogarinë korente të bilancit të pagesave [...]”, vlerësoj se është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga subjekti tregtar, në këtë rast subjekti tregtar i familjes së z. N.M., i kontrollueshëm nga Banka ICB, në të cilën janë kryer transfertat përkatëse, por edhe nga organet kompetente që monitorojnë institucionet bankare, me qëllim parandalimin dhe sanksionimin për veprime në kundërshtim me ligjin. Për këto arsye çmoj se nuk është subjekti i rivlerësimit Artor Ylli, personi përgjegjës për regjistrimin e veprimit të transferimit në llogaritë kapitale ose korrente të subjektit tregtar të familjes së z. N.M.⁵⁸, apo për më tepër t’i atribuohet atij ky mosveprim, si sjellje në kundërshtim me ligjin.

Bazuar në sa më sipër, për sa kohë që rregulli i kohës nuk kishte parashikuar kufizime në vlerë për transferim kapitali, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit Artor Ylli nuk ka pasur asnjë qëllim për shmangie nga zbatimi i rregullit të kohës, duke realizuar kryerjen e këtyre transferimeve bankare edhe nëpërmjet Bankës ICB, si dhe bazuar në interpretimin e mësipërm të rregullave të posaçme të parashikuara nga Banka e Shqipërisë, ai nuk ka kryer me veprimet apo mosveprimet e tij shkelje të legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, duke qenë se as nga Banka ICB, por siç rezulton edhe nga hetimi në kuadër të procesit të rivlerësimit, as nga Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave nuk është konstatuar shkelje e ligjit për këto transferime bankare, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit Artor Ylli nuk ka pasur asnjëherë dyshimin se veprimet e tij nëpërmjet Bankës ICB ishin në shkelje të ligjit.

10.3 Sa u përket rregullave të referuara nga shumica, në paragrafët 30.1 dhe 30.2 të vendimit, të legjislacionit në fuqi⁵⁹, i cili parashikon se si realizohet dokumentimi i importit të mallrave, por edhe i çmimit që duhet paguar për to nga shitësi të blerësi, vlerësoj se këto rregulla janë të

⁵⁶ *Institucionet financiare të licencuara për të kryer këto transferta.*

⁵⁷ *Duke qenë se, siç ka rezultuar në procesin e rivlerësimit në Komision, por siç e pranon edhe shumica në paragrafin 31.1 të vendimit, subjekti i rivlerësimit në periudhën 2010-2014 kishte qarkullim e fitim “0 lekë”, por edhe objekti i veprimtarisë së tij (si avokat) nuk i lejonte të kishte mundësinë për të kryer marrëdhënie tregtare jashtë vendit.*

⁵⁸ *Duke qenë se nuk është provuar gjatë hetimit administrativ në Komision, që subjekti të kishte ndonjë cilësi apo detyrë të posaçme financiare në këtë aktivitet.*

⁵⁹ *Neni 51, pika 1 e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, si dhe pika 46.1.10 e udhëzimit të ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008, i ndryshuar.*

detyrueshme për t'u zbatuar nga blerësi në një marrëdhënie tregtare dhe për çështjen në fjalë ishin të detyrueshme për t'u zbatuar nga personat e ngarkuar nga ligji për të kryer këto veprime për llogari të aktivitetit familjar të z. N.M., por jo nga subjekti i rivlerësimit, i cili siç ka rezultuar e provuar gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, nuk kishte ndonjë cilësi apo përgjegjësi të posaçme financiare në këtë aktivitet.

Aktiviteti tregtar i familjes së z. N.M. duhet të ketë qenë objekt kontrolli nga organet kompetente tatimore dhe doganore, por nga hetimi gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, rezulton se nuk janë administruar akte të organeve tatimore, doganore apo të organeve të tjera kompetente kontrolluese, sipas të cilave z. N.M. të ishte hetuar dhe më tej ndëshkuar me sanksione administrative apo edhe penale për veprime të kundërligjshme gjatë aktivitetit të tij tregtar. Edhe shumica në vendim nuk mbështet vlerësimin e Komisionit që subjekti i rivlerësimit kishte dijeni që "[...] ky ishte një veprim i cili favorizonte biznesin e z. N.M., duke kryer evazion tatimor", si dhe ka pranuar në thelb që nuk janë organet e rivlerësimit ato që mund të vlerësojnë nëse aktiviteti tregtar i familjarëve të z. N.M. ka qenë në shkelje të ligjit në këndvështrimin e pagimit të detyrimeve tatimore dhe doganore, por janë organet kompetente ato që bëjnë hetimin, vlerësimin dhe sanksionimin, sipas shkeljes përkatëse të konstatuar.

Bazuar në interpretimin e legjislacionit të sipërcituar, si dhe në provat e administruara në procesin e rivlerësimit, jo vetëm që referimi nga shumica në vendim të legjislacioni tatimor dhe doganor nuk ka relevancë për të konkluduar se për shkak të mosparaqitjes së këtyre akteve nga z. N.M. apo subjekti Artor Ylli, ai ka shkelur ligjin, por vlerësoj se gjatë procesit të rivlerësimit nuk është provuar që aktiviteti tregtar i familjes së z. N.M. ishte në shkelje të ligjit. Gjithashtu, nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të ketë prezumuar se në kohën e kryerjes së transfertave bankare ky aktivitet nuk ka qenë ushtruar në përputhje me ligjin.

11. Në përfundim, vlerësoj se konkluzionet e Komisionit, të mbështetura dhe nga shumica në vendim, se subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës 2010-2012, për transferimet e shumave nëpërmjet Bankës ICB, nuk ka justifikuar me burime të ligjshme këto shuma, si dhe ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për transferimin e tyre, nuk qëndrojnë dhe nuk plotësojnë asnjë prej elementeve të parashikuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ndaj nuk mund të merren në konsideratë për kualifikimin e tyre si shkelje, brenda përcaktimeve të nenit 61, pika 33, si dhe në vlerësimin tërësor të çështjes sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

II. Detyrimet tatimore të subjektit të rivlerësimit Artor Ylli gjatë ushtrimit të aktivitetit të avokatit

12. Ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën në paragrafin 44 të vendimit, duke mos pranuar përfundimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për detyrimin tatimor ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në shumën 242.618 lekë dhe Njësisë Administrative Kashar në shumën 143.780 lekë, si dhe bashkohem me shumicën sa i përket interpretimit për detyrimet që i kishin lindur subjektit të rivlerësimit Artor Ylli për periudhën që ai ka ushtruar aktivitetin e avokatit, në zbatim të legjislacionit në fuqi për pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
13. Pavarësisht sa më sipër, me qëllim kryerjen e një vlerësimi objektiv dhe proporcional, lidhur me mospagimin në kohë të këtyre detyrimeve tatimore dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore,

nga subjekti i rivlerësimit Artor Ylli për periudhën kur ai ka ushtruar aktivitetin e avokatit dhe pasojën që sjell ky veprim brenda vlerësimit të kriterit të pasurisë, si dhe në vlerësimin tërësor të tij në kuadër të procesit të rivlerësimit, sjell në vëmendje se sipas akteve të administruara në proces, rezulton se subjekti:

- a) referuar shkresës nr. {***} prot., datë 10.07.2018, të DRT Tiranë, për periudhën 2010-2014, kishte qarkullim e fitim “0” lekë;
- b) ka deklaruar dhe njohur në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit detyrimet tatimore që kishte ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë dhe Njesisë Administrative Kashar;
- c) në vlerën e këtyre detyrimeve në një shumë prej 386.398 lekësh, e shtrirë në një periudhë gjatw viteve 2010-2014, një pjesë të konsiderueshme zënë gjobat e gjeneruara si rrjedhojë e mosdeklarimit në kohë të qarkullimit të aktivitetit të tij;
- ç) nuk ka krijuar pasuri të paluajtshme apo likuiditete me të ardhura nga ky aktivitet;
- d) jashtë afatit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, pas dorëzimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, por gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit, ka dorëzuar deklaratat për qëllim pagimi të detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
- dh) sipas shkresës nr. {***} prot., datë 10.07.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, detyrimi kryesor ishte “zero lekë” dhe detyrimet tatimore përbëheshin nga gjobat, në total në vlerën 193061 lekë;
- e) 5 ditë para seancës dëgjimore në Komision, ka shlyer detyrimin tatimor ndaj Njesisë Administrative Kashar;
- ë) disa ditë pas vendimit të Komisionit për “shkarkimin nga detyra”, pas marrjes së një kontrate kredie “overdraft”, ka shlyer edhe detyrimet “gjoba” ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

14. Rrethanat e sipërcituara duhet të analizohen në raport me elementet e tjera të vlerësuara në këtë mendim pakice, për t’u dhënë më tej atyre rëndësinë e duhur në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, lidhur me efektin që ato do të kenë në konsiderimin e shkeljeve të kësaj natyre, në vlerësimin tërësor të subjektit në kuadër të procesit të rivlerësimit. Ashtu si edhe shumica në vendim, kjo shkelje e konstatuar për subjektin e rivlerësimit, e vlerësuar më vete dhe si element përbërës i kriterit të kontrollit të pasurisë, çmoj se nuk mund të konsiderohet e mjaftueshme për t’u kualifikuar brenda parashikimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

III. Mbi cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë

15. Jam shprehur kundër qëndrimit të shumicës për sa i përket cilësimit si shkak shkarkimi për subjektin e rivlerësimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si pasojë e vlerësimit të sjelljes së subjektit në shkelje të ligjit për kryerjen e transfertave nëpërmjet Bankës ICB në periudhën 2010-2012, si dhe për mospagimin e detyrimeve tatimore gjatë periudhës kur ai ka ushtruar aktivitetin e tij si avokat, si një shkelje etike me pasojë cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, për arsyet si më poshtë.
16. Neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se subjektet e rivlerësimit mund të shkarkohen në rastin kur: [...] nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit. Në interpretim të këtij parashikimi ligjor, cenimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë si i tillë, duhet të plotësojë disa elemente, si: të ketë ndodhur për shkakun e pretenduar, të jetë i arsyeshëm e i konsiderueshëm

apo i perceptueshëm, si dhe për shkelje të cilat nuk mund të kualifikohen si raste të tjera shkarkimi, të parashikuara në nenin 61, pikat 1, 2, 3 e 4 të ligjit nr. 84/2016.

17. Në vlerësimin tim, analizimi i sjelljes së subjektit të rivlerësimit në drejtim të shkeljes së etikës, duke u bazuar vetëm në rezultatet e hetimit për kriterin e pasurisë, vlerësoj se nuk është në përputhje me parashikimet e neneve 40 e në vijim të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: *Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve*. Sipas nenit 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që të referon te parashikimi i nenit 75 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”), etika është një nga komponentët që vlerësohet gjatë kontrollit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe, si e tillë, ajo duhet trajtuar dhe analizuar në këndvështrim të këtij kriteri. Gjithashtu, duke pasur në konsideratë që elementet e etikës sipas ligjit nr. 96/2016, përfshijnë si sjelljen gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe jashtë saj, vlerësoj se këto elemente duhet të analizohen në raport me elementet e tjera të vlerësimit të këtij kriteri, për të konkluduar më tej në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, efektin që ato do kenë në konsiderimin e shkeljeve të kësaj natyre⁶⁰. Besimi i publikut mund të cenohet sa herë që ekziston një arsye për të vënë në dyshim integritetin e funksionarit publik, i cili ushtron një autoritet publik, ndërkohë që integriteti i funksionarit/magjistratit mund të vihet në dyshim sa herë që ai shkel ligjin gjatë ushtrimit të detyrës apo dhe jashtë saj (në periudhën kur është në shërbim në një funksion/detyrë publike).
18. Ndryshe nga shumica, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit është përfshirë në procesin e rivlerësimit si ndihmës ligjor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe, referuar arsyetimit të mësipërm, si dhe përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, vlerësimi i etikës dhe i sjelljes së tij duhet të bëhet për këtë periudhë, ashtu siç është bërë nga Komisioni edhe vlerësimi i aftësive profesionale të tij, krahas gjithë elementeve të tjera, të parashikuara në nenin 75 e në vijim të ligjit nr. 96/2016. Në kohën kur pretendohet që janë kryer këto shkelje, subjekti i rivlerësimit Artor Ylli nuk ka qenë në detyrën, për shkak të së cilës i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, pra edhe sjellja e tij e pretenduar nga shumica në vendim si në shkelje të ligjit në kohën kur janë kryer këto veprime, nuk mund të ketë sjellë vënien në dyshim të integritetit të një personi në detyrë publike dhe, për rrjedhojë, të ketë sjellë cenim të besimit të publikut. Për më tepër, në arsyetimin e mësipërm, të gjendjes faktike të provuar dhe në ligj, argumentova se subjekti i rivlerësimit Artor Ylli me veprimet apo mosveprimet e tij nuk ka kryer shkelje të ligjit sa u përket transfertave bankare të kryera prej tij nëpërmjet Bankës ICB, për rrjedhojë nuk mund të konkludohet që ai ka pasur një sjellje joetike, në kundërshtim me vlerat themelore që duhet të kenë personat që do të bëhen pjesë e sistemit të drejtësisë. Gjithashtu, lidhur me mospagimin e detyrimeve tatimore në kohë gjatë periudhës kur ai ka ushtruar aktivitetin e avokatit, duke pasur në konsideratë rrethanat e parashtruara më sipër në pjesën II, paragrafi 13 i këtij mendimi, vlerësoj se rëndësia e tyre nuk është e tillë që në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit të afektojë vlerësimin tërësor të tij në kuadër të procesit të rivlerësimit dhe të passjellë dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

⁶⁰ Qëndrim i mbajtur si gjyqtare në pakicë në vendimin nr. 28/2019 (JR), datë 30.10.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

IV. Mbi zgjidhjen e çështjes

19. Mbështetur në arsyetimin e mësipërm, duke qenë se shkaqet për të cilat është vendosur shkarkimi nuk u gjendën prej meje të bazuara në prova dhe në ligj, kam votuar kundër disponimit të trupit gjykues për “shkarkimin nga detyra” të subjektit të rivlerësimit Artor Ylli, bazuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe kam votuar për ndryshimin e vendimit nr. 73, datë 02.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe “konfirmimin në detyrë” të tij, sipas nenit 66, pika 1, shkronja “b” e po këtij ligji.

GJYQTARE

Albana Shtylla

nënshkrimi